OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOSA I TRŽIŠTA KOSTT d.d
Nr. 3113 Dt. 24 10 2024
PRISHTINË-A

# PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2025

Bordi i Drejtorëve i KOSTT Sh.A. në mbledhjen 154/24 të dt.19 tetor 2024 me vendimin vijues miratoi Planin e Biznesit për vitin 2025:

**Vendim 241019/II-6**

Bordi i Drejtorëve bazuar në nenin 30 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike si është ndryshuar dhe plotësuar dhe nenin 14.2.2.5 të Statutit të Shoqërisë Aksionare KOSTT, njëzëri miratoi Planin e Biznesit për vitin 2025.

| | Përgatiti | Kontrolloi | Aprovoi |
|---|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Nebih Haziri<br>Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit | Evetar Zeqiri<br>Kryeshef Ekzekutiv | Bordi i Drejtorëve<br>Liza Marku<br>Ajrina Gashi-Hamdiu<br>Sead Mujovi<br>Evetar Zeqiri |
| Nënshkrimi | [signature] | [signature] | [signatures] |
| Data | *Tetor, 2024* | 2024 | 2024 |

**Përmbajtja**

1. HYRJE ... 8
2. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT THEMELORE TË KOSTT-it ... 10
 2.1. Objektivat strategjike ... 11
 2.2. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Pajtueshmërisë ... 11
 2.3. Organizimi ... 12
 2.4. Ristrukturimi i strukturës organizative ... 15
3. SWOT (PËRPARËSITË, DOBËSITË, MUNDËSITË DHE KËRCËNIMET) ANALIZA ... 17
4. RRETHINA AFARISTE ... 20
 4.1. Zhvillimi i sektorit të energjisë elektrike ... 20
  4.1.1. Historiku pas vitit 2000 ... 20
 4.2. Zhvillimet në KOSTT ... 21
  4.2.1. Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të sistemit dhe transmetimit ... 21
  4.2.2. Kapacitetet Gjeneruese ... 23
 4.3. Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të tregut ... 26
  4.3.1. Liberalizimi i tregut dhe mundësit e integrimit në tregun e përbashkët rajonal ... 26
5. LIBERALIZIMI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ... 27
 5.1. Integrimi rajonal ... 27
 5.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit ... 28
  5.2.1. Objektivat kryesore dhe sfidat nga aspekti i operimit të tregut ... 28
 5.3. Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë ... 30
6. IMPLEMENTIMI I ARANZHMANEVE TË REJA OPERATIVE ... 31
 6.1. Korniza rregullative dhe tarifat ... 32
 6.2. Projektet e reja të ndërlidhura me bizneset jo të rregulluara ... 35
7. ÇËSHTJET SOCIALE DHE MJEDISORE ... 35
8. PLANI INVESTIV ... 38
 8.1. Plani Zhvillimor dhe investiv i Rrjetit të Transmetimit (PZHIT&PIZHT) ... 38
 8.2. Përshkrimi i disa projekteve më të rëndësishme ... 39
  8.2.1. Projektet në vazhdimësi ... 39
  8.2.2. Projektet e planifikuar për vitin 2025 ... 43
9. TABELA E INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2025 ... 45
10. PLANIFIKIMI FINANCIAR ... 52
 10.1. Struktura dhe vlera e të hyrave për vitin 2025 ... 53
 10.2. Shpenzimet operative ... 53
 10.3. Planifikimi i Pasqyrës së të Ardhurës ( Fitimit/Humbjes) për vitin 2025 ... 55
 10.4. Parashikimi i rrjedhës së parasë së gatshme 2025 ... 56
11. QËNDRUESHMËRIA AFARISTE ... 57

11.1. Personeli ....57
11.2. Implementimi dhe matja e performancës ....58
11.3. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore....58
11.4. Menaxhimi i cilësisë ....59
11.5. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit(TIK) ....60
11.6. Menaxhimi i ndërtesave ....61
11.7. Marrëdhëniet efektive me palët e interesit ....62
11.8. Prokurimi Elektronik ....64

**Tabela:**

*Tabela 1. Investimet Kapitale* ........ *45*
*Tabela 2. Të hyrat* ........ *53*
*Tabela 3. Pasqyra e të Ardhurave* ........ *55*
*Tabela 4. Rrjedha e Parasë* ........ *56*

**Figura:**

*Figura 1. Makro Struktura organizative e KOSTT-it* ........ *14*
*Figura 2. Pjesëmarrja e prodhimit të energjisë sipas teknologjive në vitin 2023* ........ *24*

**Lista e shkurtesave**

AATC (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)
ALPEX (Albanian Power Exchange)- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
ATC (Available Transfer Capacity ) – Kapaciteti i disponueshëm
ATR Autotransformatori
AMR Automatic Metered Reading
BB Banka Botërore
BD Bordi i drejtorëve
BE Bashkimi Evropian
BNJ Burimet njerëzore
BRE Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CAO ( nga angl. Coordinated Auction Office) – Zyra për Koordinimin e Ankandeve
CAS Sistemi i Kompjuterizuar i Kontabilitetit
CGES Sistemi Transmetues i Malit të Zi (Crnogorski Elektroprenosni Sistem)
CGMES Common Grid Model Exchange Standards
DACF Day Ahead Congestion Forecast (Parashiqimi i kongjestionit një ditë para)
DfD Mitigation Measures Investigation
EAS Energy Awerness System
ECLO ( nga angl. European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
EH Electronic Highway
EIC (nga angl. Energy Identification Code) – kodi i identifikimit për energji
EJL Evropa Jug Lindore
ENTSO-E ( nga angl. European Network of Transmission System Operators for Electricity) – Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike
EMS Rrjeti Elektrik i Serbisë (Elektro Mreza Srbije)
EPS Elekroekonomia e Serbisë (Elektroprivreda Srbije)
ERE Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri)
GIS ( nga angl.Gass Insulated Switchgear)
HC Hidrocentral
ITC Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmetimit)
KEK Korporata Energjetike e Kosovës
KfW nga gjerm.Kreditanstalt für Wiederaufbau – Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim
KQKO Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale
IEC International Electrotechnical Commission (Komisioni Ndfërkombëtar Elektroteknik)
LP largpërçues
MATC Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)
MEPSO Electricity Transmission System Operator of the Republic of North Macedonia (Operator i Sistemit Elektrotransmetues i republikës së Maqedonisë së Veriut)

MBE Marrëveshje për blerje të energjisë
MSA Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MR Mbrojtje Rele
MPMS Ministria e punës dhe mireqenjes sociale
NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës
NIF (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës
NP Ndërmarrje publike
NS Nënstacioni
OHSAS Standardi për auditimin e shëndetit dhe sigurisë (në angl.Ocuppational Helth and Safety Auditing System)
OPGW ( Optical Power Grud Wire) – Kablli me fibër optik
OST Operator i Sistemit të Transmetimit
PSHK Përgjegjësi Shoqërore Korporative
PZHT Plani Zhvillimor i Transmetimit
QND Qendra Nacionale Dispeçerike
QEND Qendra Emergjente Nacionale DispeçerikeRG-SEE - Grup regjional në ombrellën e MC –Market Committee – Komiteti i tregut i ENTSO-E
MBE Marrëveshja për Blerjen e Energjisë
OPC Outage Planning Coordination
OPDE Operational Planning Data Environment
OSH Operatori i Shperndarjes
OT Operatori i Tregut
RSC Regional Security Coordination (Koordinimi Rajonal për Siguri)
SAFA Synchronous Area Operational Agreement Policy 1 Load Frequency Control and Reservs
SCADA/EMS nga angl. Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System (Mbikqyrja e Kontrollit dhe Përvehtësimit të të Dhënave/Sistemi i Menaxhimit të Energjisë)
SCC Security Critical Coordination
SCS Substation control system
SEE Sistemi Elektro Energjetik
SEE CAO- Zyra për alokim të koordinuar të kapaciteteve interkonektive në EJL
SG-CMMI Nëngrupi për menaxhimin e kongjestioneve dhe integrimin e tregut
SMTA Short &medium term generation adequacy
SO Sistem Operator (Operatori i Sistemit)
SOGL System Operation Guideline
TKE Traktati i Komunitetit të Energjisë
TTC Total Transfer Capacity
USAID (Unated States Agency for International Development)- Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
VNM Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

| | |
|---|---|
| VP | Platforma e verifikimit |
| ZRrE | Zyra e Rregullatorit të Energjisë |
| ZSMZ | Zyra e Sigurisë dhe Mbrojtjes nga Zjarri |

## 1. HYRJE

KOSTT-i si ndërmarrje e mëvetësishme, është krijuar si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë, që është në harmoni me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, ku Kosova është anëtare me të drejta të barabarta.

I emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i licencuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë në bazë të dispozitave të legjislacionit parësor dhe dytësor të Kosovës, KOSTT sh.a. në tetor të vitit 2006, u licencua si: Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operator i Tregut të energjisë elektrike. KOSTT po ashtu mban Autorizimin/Licencën për komercializimin e infrastrukturës fibër optike, të lëshuar nga ARKEP.

Më 07.12.2009 KOSTT është ri-regjistruar si Ndërmarrje Publike, me emërtimin e plotë: "Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT" SH.A.

Me 13.04.2017 mbi bazën e ndryshimeve në legjislacionin bazik dhe rregullin e ri të licencav, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka lëshuara licencat e modifikuara për KOSTT.

Modifikimi i licencave mbi bazën e ndryshimeve në legjislacionin bazik dhe rregullin e ri të licencave të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përcaktuar me licencat e modifikuara të lëshuara më 13.04.2017.

KOSTT sh.a, funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST), KOSTT-i është përgjegjës për operim të sigurt, të besueshëm, ekonomik dhe të koordinuar të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe është përgjegjës për menaxhimin e rrjedhave të energjisë në rrjetin e transmetimit, për të ndihmuar furnizimin e konsumit nacional dhe tregtimit ndërkufitar.

Si Operator i Tregut të energjisë elektrike, KOSTT-i është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike si dhe për menaxhimin e procesit të barazimeve përfundimtare.

Në përputhje me Ligjin e Energjisë Elektrike dhe licencat e lëshuara, KOSTT është përgjegjës për:

- Transmetimin e energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në licencë, në mënyrë objektive, transparente dhe jo diskriminuese në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ruajtur sigurinë e sistemit elektroenergjetik sipas këtij ligji;
- Operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmetimit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri afatgjatë të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit;
- Administrimin, operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese;

- Operimin e Sistemit të Transmetimit në pajtueshmëri me Kodin e rrjetit të transmetimit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme, në mënyrë që të arrijë sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimin ekonomik të rrjetit të transmetimit;
- Planifikimin e operimit të sistemit elektroenergjetik, në bashkëpunim me Operatorin e Tregut dhe operatorët e sistemeve të transmetimit të shteteve fqinje, si dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe shfrytëzuesve të Rrjetit;
- Balancimin e sistemit të energjisë elektrike në harmoni me Kodin e Rrjetit të transmetimit dhe Rregullat e Tregut;
- Sigurimin e besueshmërisë dhe disponueshmërisë së sistemit të transmetimit, në mënyrë që të mundësojë furnizim të sigurt me energji elektrike, duke mbajtur mjaftueshmërinë e kapaciteteve të transmetimit;
- Mundësimin përdoruesve në qasje dhe shfrytëzim të rrjetit të transmetimit sipas parimeve transparente dhe jo diskriminuese;
- Shkëmbimet e informacioneve të nevojshme me operatorët e sistemeve fqinje, me të cilët është i ndërlidhur sistemi i transmetimit, me qëllim të arritjes së operimit të sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve të interkonektuara;
- Përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës SCADA/EMS për realizimin e funksioneve të operimit të sistemit të transmetimit;
- Menaxhimin e fondit BRE;
- Menaxhimin e procesit të ndërrimit të furnizuesit;
- Përveç përgjegjësive primare të cekura më lartë, KOSTT ka edhe përgjegjësitë sekondare, që janë:
- që të ofrojë shërbimet e shfrytëzimit të fibrave optik (komercializimi i fibrave optik) në infrastrukturën e telekomunikacionit në të tërë vendin, si dhe vendet e rajonit në bashkëpunim me OST-të përmes rrjetit të transmetimit të KOSTT dhe linjave interkonektive. Në këtë drejtim, përgjegjësitë e KOSTT-it përcaktohen nga Ligji për Komunikime Elektronike si dhe Autorizimi/Licenca e lëshuar nga ARKEP-i;
- dhënia e shërbimeve të konsulencës;
- ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta (kyçja e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në rrjetin e transmetimit, si dhe ndërtimet e objekteve afër rrjetit të transmetimit).

Rrjeti i Transmisionit nën Zonën e Kontrollit të KOSTT, luan një rol të rëndësishme në tregun rajonal të energjisë elektrike dhe ndërlidhet me katër sisteme të tjera: atë të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi.

Plani i Biznesit për periudhën 2025 është punuar me qëllim të fokusimit në arritjen e objektivave strategjike, përmbushjes së misionit dhe vizionit të KOSTT, gjithnjë duke u mbështetur në vlerat themelore të KOSTT, të cilat janë ndërtuar për vite me radhë.

Ky Plan i Biznesit është në harmoni me periudhën e tretë tarifore, ku përcaktohen të Hyrat Maksimale të Lejuara për KOSTT-in për këtë periudhë, prandaj do të konsiderohet si vegël për të siguruar arritjen e niveleve të parapërcaktuara të performancës brenda kornizës së të Hyrave Maksimale të Lejuara nga ZRrE.

## 2. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT THEMELORE TË KOSTT-it

**Misioni**

Misioni i KOSTT-it është:

- Operimi i sigurt dhe i besueshëm i Sistemit të Transmetimit, duke garantuar sigurinë e furnizimit, si dhe operimin efikas të tregut të energjisë elektrike në bazën e transparencës dhe jo diskriminimit, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës.

**Vizioni**

- “Të jetë kompani kredibile, që garanton transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptimin social dhe mjedisor, e integruar në rrjetet dhe institucionet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike“.

***Vlerat themelore***

**Siguria dhe Besueshmëria**: transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike për të gjitha palët e kyçura në Sistemin e transmetimit të Kosovës, në përmbushje të objektivës për sigurinë e furnizimit cilësor dhe zhvillim të qëndrueshëm.

**Përgjegjësia**: në përmbushjen e obligimeve si kompani publike KOSTT përdor resurset në mënyrë sa më optimale dhe është e përkushtuar në mirëmbajtjen, zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm të Sistemit të transmetimit duke krijuar vlerë për aksionarin. KOSTT është e përkushtuar dhe e përgjegjshme ndaj palëve, punonjësve, komunitetit, mjedisit dhe shoqërisë në përgjithësi.

**Bashkëpunimi**: KOSTT-i vazhdimisht favorizon dhe kultivon bashkëpunimin dhe punën ekipore, që shpie në kryerjen e detyrave drejt arritjeve të përbashkëta, për të përmbushur misionin e saj dhe zhvillimin afatgjatë të kompanisë.

**Transparenca:** KOSTT qeveriset mbi bazën e transparencës dhe llogaridhënies. KOSTT ofron qasje jo-diskriminuese për të gjitha palët e kyçura në Rrjetin e transmetimit, zbaton me transparencë procedurat si dhe ofron informacione të hapura për të gjitha palët e tregut të energjisë elektrike, palët e interesit dhe opinionit në përgjithësi.

**Dija**: përmes përvetësimit të vazhdueshëm të njohurive, dhe përvojës shumëvjeçare, KOSTT ndërton profesionalizmin e tij, përmirëson performancën dhe mbetet e përkushtuar në gjetjen e zgjidhjeve më të mira për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

**Moto e KOSTT-it**

**Energjia jonë, zëri i së ardhmes!**

## 2.1. Objektivat strategjike

Objektivat strategjike të KOSTT-it janë në harmoni me objektivat themelore shtetërore për zhvillimin e sektorit të energjisë, të përcaktuara me Strategjinë e Energjisë 2022-2031.

Objektivat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballet në të ardhmen.

Objektivat e KOSTT-it janë:

1) Operimi i Sistemit Elektroenergjetik (SEE) të Kosovës në mënyrë të sigurt dhe të besueshëm, duke balancuar në mënyrë konstante SEE;
2) Mirëmbajtja e Sistemit të transmetimit;
3) Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;
4) Zhvillimi i tregut konkurrues te energjisë elektrike;
5) Sigurimi i stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të kompanisë;
6) Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
7) Avancimi i qeverisjes së mire korporative dhe partneritetit me palët e interesit;
8) Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve, avansimi i barazisë gjinore, gjithë përfshirja, dhe diversiteti;
9) Të jetë kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, në aspektin social dhe mjedisor me fokus të përkrahjes në procesin e dekarbonizimit;
10) Të zhvilloj dhe mirëmbajë një ambient të sigurt pune dhe të shëndetshëm;
11) Menaxhimi kualitativ dhe avancimi i ndërmarrjes sipas Standardeve Ndërkombëtare;
12) Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, inovacionit dhe sigurisë kibernetike;
13) Akomodimi i kyçjeve të reja në rrjetin e transmetimit; dhe
14) Sigurimi dhe menagjimi i sistemit permes teknologjive të reja fleksil.

## 2.2. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Pajtueshmërisë

Arritja e objektivave strategjike padyshim që përmban në vetvete rreziqe drejt arritjes së tyre. Menaxhimi i Rreziqeve si dhe sigurimi i Pajtueshmërisë luajnë një rol të rëndësishëm drejt arritjes së objektivave strategjike të ndërmarrjes. Gjatë realizimit të planit të biznesit për vitin 2024, menaxhimi i rreziqeve do të jetë pjesë qenësore. Kjo do të bëhet përmes inicimit të krijimit të një kornize të brendshme të menaxhimit të riskut dhe një sistemi të menaxhimit të rrezikut. Për të bërë këtë, KOSTT ka angazhuar një ekspert të rrezikut i cili do të zhvilloj një sistem të menaxhimit të rreziqeve, përfshirë parimet e menaxhimit të rreziqeve, listën apo regjistrin e rreziqeve, hartën/matricën e rreziqeve dhe veprimet për menaxhimin e tyre.

Menaxhimi i rreziqeve do të kontribuoj në arritjen e objektivave strategjike të kompanisë duke ofruar një qasje të strukturuar dhe proaktive në identifikimin, dhe adresimin e rreziqeve që mund të cenojnë progresin. Do të mundësoj ndërmarrjes të bëj vendime të informuara, të mbrojë resurset, të rrisë fleksibilitetin, dhe të sigurojë besimin e aksionarit dhe hisedarëve të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025, KOSTT planifikon që menaxhimi i rrezikut të formalizohet si funksion i përhershëm në ndërmarrje duke kontribuar në nivel të përgjithshëm të ngritjes së vetëdijes dhe praktikave për menaxhimin e rreziqeve. Ne do të bashkëpunojmë ngushtë edhe me partnerët tanë ndërkombëtar duke shfrytëzuar memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar gjatë vitit 2023 me Eles ltd. për të shkëmbyer përvojën e tyre në vendosjen e një sistemi të menaxhimit të rrezikut në ndërmarrje. Kjo do të bëhet përmes vizitave dhe shkëmbimit të dokumentacionit të nevojshëm për të vënë në funksion menaxhimin e integruar të rreziqeve.

Gjithashtu, rol kyç në sigurimin e operimit të pavarur të rrjetit të transmetimit dhe në përputhje me obligimet që ka KOSTT si OST e certifikuar është konsistenca në sigurimin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore përkatëse Evropiane dhe atë vendore. Andaj, KOSTT do të sigurohet që përmes mekanizmave të nevojshëm të aplikoj masat e nevojshme për të monitoruar pajtueshmërinë e vazhdueshme të Operatorit të sistemit të transmetimit me programin e pajtueshmërisë.

### 2.3. Organizimi

Bordi i Drejtoreve të KOSTT-it në mbledhjen nr.103/18 të datës 25 prill 2018 ka aprovuar Riorganizimin e brendshëm të KOSTT, përkatësisht makro skemën organizative.

Sipas kësaj strukture, menaxhmenti më i lartë i KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Zyrtar i Auditimit të Brendshëm dhe drejtorët e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmetimit;
- Operatori i Tregut;
- Zhvillimi i Rrjetit dhe Projekteve;
- Çështjet Rregullative dhe Tarifa;
- Financat dhe Thesari;
- Burimet Njerëzore;
- Shërbimet Përkrahëse;
- Prokurimi; dhe
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyrën ligjore, Menaxheri për Cilësi dhe Politika, dhe Sherbimet Këshilluese.

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:

- Aprovimi i Ligjit të Energjisë Elektrike, Ligji i Energjisë dhe ligjet tjera primare. Po ashtu, ndikim mund të kenë edhe transpozimi i pakos së 4-të të direktivave të Bashkimi Evropian në legjislacionin sekondar.
- Aktualisht KOSTT në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes me RGCE\ENTSO-E, është duke operuar si LFC Zonë e pavarur (Zonë e pavarur Kontrolluese). Në kontekst të kësaj, ENTSO-E në vazhdimësi monitoron përmbushjen e kushteve teknike të KOSTT për operim të pavarur si LFC Zonë (LFC Area).
- Marrëveshja e Re Kyçjes me ENTSO-E dyvjeqare e cila ka hyrë në fuqi me daët 30 shtator 2024 dhe e cila pritet të vazhdojë deri në vitin 2026 ka përcaktuar obligime shtesë në kuptim të shtojcës së aplikuar nga ENTSO-E. Ky obligim shtesë kërkon një çasje më rigoroze ndaj palëve përgjegjëse për balancim dhe rritje të kapaciteteve balancuese të KOSTT përmes rritjes së shërbimeve ndihmëse (rrefullimi sekondar aFRR-, rritja nga 25MWh në 45MWh sipas planit të adekuacisë dhe rregullimit terciar mFRR). Kjo kërkesë është në linjë edhe me obligimet që rrjedhin nga licensa dhe obligimet e marra në kuadër të integrimit të BRE-ve.
- Zhvillimi i sistemit të Transmetimit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij për të arritur objektivat e strategjisë ;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë përmes përshtatjes dhe ri-organizimit funksional gjatë viti 2025;
- Projekti i Binjakëzimit me RTE France përmes RTEi pritet të ketë ndikim duke qenë që parashef përgatitjen e KOSTT për avancim të statusit të tij në ENTSO-E. Synimet janë përcaktuar që RTEi të ndihmojë KOSTT të përmbush ndryshimet e nevojshme organizative dhe teknike që do të mundësojnë arritjen e përmbushjes se kërkesave teknike të katalogut të masave të ENTSO-E drejt aspiratave për anëtarësim të plotë në ENTSO-E.
- Projekti regjional i bashkimit të tregjeve me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, përmes Memorandumit të Mirëkuptimit i nënshkruar në Nëntor të 2023 pritet të krijojë obligime shtesë në rrugën drejtë bashkimit të tregjeve në tregun evropian të energjisë.
- Nevoja për zhvillim të resurseve njerëzore dhe për zhvillim të infrastrukturës energjetike si rrjedhojë e integrimeve në institucionet ndërkombëtare Evropiane dhe rajonale, si dhe ndryshimeve dhe zhvillimeve në tregun e energjisë elektrike;
- Hyrja potenciale e KOSTT-it në tregun e telekomunikimeve të Kosovës dhe në tregun e telekomunikimeve dhe integrimin në tregun e transmetimit të të dhënave për komunikimet elektronike me vendet e rajonit. Banka Botërore është duke mbështet aktivitetet në kuadër të nismës Balkans Digital Highway(BDH). Gjatë vitit 2023, dhe vitet në vijim, janë planifikuar aktivitete dhe zhvillime për të mbështet fillimin e një projekti për ndarjen/bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës ndërkufitare të telekomunikacionit respektivisht të fibrave optik, me ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike; dhe
- Hyrja në fuqi e projektit të MCC-së dhe obligimet që kanë rrjedhur nga Marrëveshja për Implementim të Projektit, respektivisht marrja në pronësi e baterisë akumuluese 45MW 90 MWh – projekt i MCC.

Në vazhdim, është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative e KOSTT-it:




**Figura 1. Makro Struktura organizative e KOSTT-it**

### 2.4. Ristrukturimi i strukturës organizative

Duke pasur parsysh ndryshimet e vazhdueshme në zhvillim të biznesit, ndërmarrjet duhet të jenë proaktive në përshtatjen me dinamikat që ndodhin në sektorin e tyre. Zhvillimet vendore, rajonale dhe evropiane në sektorin e energjisë, përafrimi i strukturës organizative me Operatorët e Sistemeve Transmetuese/Operatorët e Tregut evropian, nevoja për të qenë fleksibil, inovativ dhe konkurruese, i bën korporatat të shohin të nevojshme të nisin një proces ristrukturimi të përgjithshëm me qëllim të përshtatjes dhe gatishmërisë për të qenë në hap me zhvillimet e tregut dhe ndryshimet legjislative apo rregullative.

Ky seksion synon të justifikojë nevojën për një ristrukturim të tillë duke theksuar përfitimet e tij të, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit operacional, shërbimin sa më të mirë të konsumatorëve fundor – qytetarëve - dhe rritjen e qëndrueshme afatgjatë. Ristrukturimi i përgjithshëm i ndëmarrjeve është proces normal të cilin ndëmarrjet publike e zbatojnë në baza periodike. Ky proces është edhe në linjë me orientimin strategjik dhe udhëzimeet e bordit të drejtorëve për të iniciuar një proces profesional të ristrukturimit.

Disa nga përfitimet kryesore të ristrukturimit janë

1) **Efikasiteti Operacional** - Ristrukturimi i ndëmarrjes lehtëson riorganizimin e strukturave organizative, duke eliminuar tepricat, duke optimizuar proceset dhe duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm. Duke përmirësuar operacionet, ndërmarrja mund të eliminojnë sfidat, të përmirësojnë kanalet e komunikimit dhe të fuqizojnë punonjësit për të marrë vendime të informuara. Përshtatja e niveleve menaxheriale dhe burokracisë mundëson kohë më të shpejta të reagimit, vendim marrjes, koordinim më efektiv dhe shpërndarje më të mirë të burimeve, duke çuar në rrjedha të efektshme të punës dhe rritje të efikasitetit operacional.
2) **Optimizimi i Kostove** - Një proces ristrukturimi strategjik do t'i mundësoj ndërmarrjes të identifikojnë fushat e shpenzimeve të panevojshme dhe të zbatojnë masa për kursimin e kostos. Duke eliminuar funksionet e dyfishta, duke konsoliduar departamentet dhe duke optimizuar shpërndarjen e burimeve, ndërmarrja mund të reduktojnë kostot e përgjithshme, të thjeshtojnë proceset e brendshme, të rris efikasitetin dhe përmirësoj procesin e vendim-marrjes. Kursimet e kostos që rezultojnë mund të riinvestohen në projekte inovative, zhvillimin e talenteve dhe zgjerimin e tregut, duke rritur përfundimisht përfitimin dhe vlerën e aksionerëve.
3) **Përshtatja me Zhvillimet e Tregut dhe Kornizën Legjislative/Rregullative** – Industritë janë vazhdimisht në zhvillim, të ndikuar nga përparimet teknologjike, ndryshimi i kuadrit ligjor, rregulliv dhe ndryshimet në mënyrën e të bërit biznes. Sektori i energjisë ka pësuar ndryshime domethënse dhe pritet të përjetoj ndryshime edhe më të tutjeshme në vitet në vijim. Përafrimi me tregun evropian, aprovimi i strategjisë së energjisë 2022-2031 nga Qeveria e Kosovës, bashkimi i tregjeve regjionale dhe integrimi në një treg të vetëm evropian, krijimi i bursës shqiptare të energjisë dhe cedimi i drejtave të organizmit të tregut një ditë para dhe ndërditor, dhe ligji i ri për burime të ripërtritshme, kërkojnë përshtatje të ndërmarrjes për të akomoduar kërkesat gjithnjë në rritje të sektorit të energjisë. Përveç kësaj, rritja e pritjeve nga aksionari, zhvillimet teknologjike dhe digjitale në sektorin e energjisë, aprovimi i planit investiv 5 vjeçar

dhe planit zhvillimor dhjetë vjeçar nga Rregullatori i Energjisë, kërkojnë kuadër njerëzore mirë të përgatiru dhe një strukturë të duhur për të adresuar kërkesat gjithnjë më sfiduese.

Një proces i ristrukturimit të ndërmarrjes i udhëhequr nga kompani të specializuara dhe lidere me përvoje ndërkombëtare dhe kombëtare në sektor të energjisë dhe ristrukturive korporative, i pajis organizatat me shkathtësinë e nevojshme për t'u përshtatur me ndryshimet e tregut me shpejtësi. Duke optimizuar burimet, duke investuar në teknologji të reja dhe duke nxitur një kulturë inovacioni, ndërmarrjet publike mund të përfitojnë nga mundësitë në zhvillim, të diversifikojnë rrjedhat e të ardhurave dhe të qëndrojnë përpara. Ristrukturimi ofron kornizën për të ushqyer një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm, duke i lejuar kompanitë të identifikojnë dhe kapin tendencat e tregut që mund të nxisin një rritje të qëndrueshme afatgjatë dhe duke krijuar vlerë të shtuar për aksionarin dhe konsumatorin fundor.

4) **Angazhimi dhe Ruajtja e Talentëve** – Sektorët që kërkojnë numër të konsiderueshëm të stafit profesional inxhinierik, e në veçanti sektorët e energjisë jo vetëm në Kosovë por edhe në vendet në rajon dhe Evropë viteve të fundit po përballen me sfida unike të mungesës së kuadrove me shkathësitë e nevojshme njerëzore. Nisma e ristrukturimit i ofron ndërmarrjes një mundësi për të optimizuar talenteve, duke siguruar që njerëzit e duhur të jenë në rolet e duhura. Duke përafruar strukturat organizative me objektivat strategjikë, kompanitë mund të krijojnë rrugëtim të qartë të zhvillimit në karrierë, të nxisin një kulturë fuqizimi dhe të ofrojnë mundësi zhvillimi profesional. Kjo qasje rrit angazhimin e punonjësve, tërheq talentin kryesor dhe redukton largimin e stafit deficitar – inxhinierëve. Punonjësit e angazhuar dhe të motivuar kanë më shumë gjasa të nxisin inovacionin, të kontribuojnë në suksesin organizativ dhe të krijojnë një mjedis pune pozitiv.

KOSTT ka angazhuar një kompani konsulente përmes një procesi konkurrues të prokurimit publik për ri-strukturimin e ndërmarrjes në linjë me legjislacionin qeverisës në Kosovë dhe ambicjet për anëtarësim me të drejta të plota në ENTSO-E, gjithënjë duke marrë në konsideratë arritjen e misionit dhe vizionit të ndërmarrjes dhe shërbimit ndaj qytetarit si konsumator fundor.

Prandaj, marrë për bazë përfitimet e shumëta të ristrukturimit siç janë optimizimi i kostove, rritja e efikasitetit organizativ, përshtatja me zhvillimet e tregut dhe legjislative/rregullative, dhe nevoja për ruajtje të talentit, janë vetëm disa nga përfitimet e një procesi të mirëfillt të ristrukturimit. Së këndejmi, procesi i ristrukturimit të strukturës organizative, strategjisë korporatave i cili ka filluar në vitin 2024 do të përmbyllet në një periudhë sa më optimale gjatë vitit 2025.

Ky proces to të udhëqhiqet nga parimet e transparencës, eksperzitës, gjithë-përfshirjes dhe do të fokusohet në një proces i bazuar në optimizm të funksioneve dhe shërbimit sa më të mirë të vizionit, misionit dhe përmbushjes së mandatit ligjor që ka ndërmarrja, pra operimi i sigurt dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit, sigurisë së furnizimit, operim efikas të tregut të energjisë elektrike duke u bazuar në parimet e transparencës, jo diskriminimit, dhe në mbështetje të zhvillimit ekonomiko shoqëror të Republikës së Kosovës.

## 3. SWOT (PËRPARËSITË, DOBËSITË, MUNDËSITË DHE KËRCËNIMET) ANALIZA

Për të bërë vlerësimin e mundësive dhe kërcënimeve me të cilat do të ballafaqohet KOSTT-i, është kryer një analizë SWOT[1].

Rezultatet e kësaj analize janë përmbledhur në vijim;

**Sfidat e Përgjithshme**

Kjo pjesë përshkruan sfidat më afatgjata me të cilat KOSTT përballet të cilat kryesisht dalin nga Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës dhe janë adresuar për arritjen e objektivit të integrimit në tregun rajonal të energjisë, e që lidhen me:

- Operimi i suksesshëm i KOSTT-it si zonë rregulluese e pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri (KS-AL) në kontest të balancimit të sistemit pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Re të Kyçjes 2024-2026.
- Zgjidhja e kontesteve dhe pretendimeve të obligimeve dhe të drejtave me TSO-të e vendeve fqinje para se KOSTT të krijojë bllokun rregullues (Shqipëri-Kosovë).
- Avancimi i statusit të KOSTT në ENTSO-E dhe obstruksionet e mundshme gjatë procesit. Tejkailimi i pengesave në procesin e aderimit dhe marrja e statusit Observer/Vëzhgues në Tregun e Përbashkët të Ditës në Avancë (SDAC) dhe brenda-ditor (SIDAC). Mobilizimi i resurseve të nevojshme nga Operatori i Tregut dhe stafi tjetër për t'u përkushtuar dhe për të marrë njohuritë e nevojshme teknike në këtë proces paraqet një sfidë në vete. Harmonizimi i bazës ligjore me direktivat e BE-së;
- Përgjegjësitë shtesë nga Operatori i Tregut që janë krijuar nga Ligji për Burime të Ripërtritshme që ka krijuar Operatorin e Burimeve të Ripërtëritshme, pritet të paraqet një sfidë në rast se kjo përgjegjësi me vendim të ZRrE-së i përcakohet KOSTT.
- Sigurimi i rezervave të mjaftueshme balancuese për sistemin, veçanërisht në kontest të integrimit të BRE-ve; Një sfidë tjetër në këtë kontext praqitet edhe arritja e kapaciteteve balancuese të nevojshme për integrimin e BRE-ve dhe digjitalizimi i proceseve rutinore në Operatorin e Tregut paraqet një sfidë po ashtu.
- Avansimi i statusit në ENTSO-E në kontest të përmbushjes së obligimeve kontraktuale;
- Integrimin në tregun rajonal dhe pan Evropian të energjisë veçanërisht në platformat e sigurimit të produkteve balancuese;
- Operimi me sukses pozitiv financiar në mungesë të obligimeve financiare nga Qeveria e Kosovës për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore që janë shkaktuar deri me 31.12.2024.

[1] *Strengths- Përparësitë, Weakness- Dobësitë, Oportunities- Mundësitë, Threats-Kërcënimet*

- Adresimi i rekomandimeve të procesit të ristrukturimit dhe riorganizimit të punës në kuptim organizativ dhe financiar për të përmbushur pritjet e stafit, dhe hisedarëve tjerë.
- Sigurimi i të hyrave të lejuara të nevojshme financiare për anëtarësim në nismat regjionale Regional Coordination Center (RGC) dhe të tjera, si parakusht për bashkimin e tregjeve me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë.
- Siguria Kibernetike dhe Siguria e Informacionit përfshirë Digjitalizimi i operacioneve.

Rezultatet e kësaj analize janë përmbledhur në vijim;

Kjo pjesë përshkruan në mënyrë më të fokusuar katër elementet kryesore të analizës SWOT duke u fokusuar në aspektet e brendshme dhe të jashtme.

**Përparësitë**

KOSTT konsideron si përparësi:

- Rrjet i zhvilluar transmetues në pajtueshmëri me kodet teknike në fuqi;
- Kapacitetet e transmetimit interkonektiv të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare;
- Operimi i KOSTT-it si zonë rregulluese e pavarur në kuadër të bllokut rregullues Kosovë Shqipëri;
- Kapacitetet njerëzore dhe teknike të nivelit të avancuar për të dhënë shërbime profesionale, dhe për zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullative;
- Largimin e mandatit të vendosur nga rregullatori për balancim të katër komunave veriore me vendim të ZRrE-së.
- Integrimi i plotë faktik dhe juridik të perimetrit energjetik të arritur gjatë procesit të zbatimit të obligimeve të dalura nga Udhërrëfyesi i Energjisë i fasilituar nga Bashkimi Evropian dhe udhëhequr nga Qeveria e Kosovës.
- Kredibiliteti i arritur në raport me palët e interesit dhe institucionet financiare ndërkombëtare përkundër ballafaqimit me krizën energjetike dhe mandatet e pa financuara të vendosura nga KOSTT;
- Krijimi i bashkëpunimeve të reja me partnerë ndërkombëtarë për të siguruar asistencën e nevojshme teknike për anëtarësim të plotë në ENTSO-E dhe rritur gatishmërinë tonë drejtë këtij procesi.
- Zotimet qeveritare për të mbështetur KOSTT në procese të rëndësishme të integrimit të BRE-ve përmes ankandeve konkurruese (solare dhe me erë) në arritjen e obligimeve kontraktuale të bazuara në legjislacion dhe licensat e oprimit të Tregut dhe Sistemit.
- Është nyje e rëndësishme e sistemit të transmetimit rajonal;
- Cilësia e menaxhimit në harmoni me ISO;
- Aprovimi i kornizës dhe themelimi i funksionit për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve korporative që i ekspozohet KOSTT-i; dhe

- Përfitimet nga partneriteti dhe mbështetja nga organizatat të brendshme dhe të jashtme në programe të përbashkëta për përmirësime të vazhdueshme të biznesit të KOSTT.

**Dobësitë**

Në anën tjetër, KOSTT ka identifikuar edhe dobësi si:

- Mosha e mesatare e shtyrë e punonjësve;
- Integrimi i pjesshëm në mekanizmat dhe asociacionet rajonale;
- Mungesa e burimeve fleksibile në SEE të Kosovës për sigurimin e rezervave balancuese;
- Mosha mesatare e transformatorëve të fuqisë dhe linjave të tensionit të lartë;
- Mungesa e aftësimit profesional për mirëmbajtjen për asetet e teknologjive të reja (Linjat dyfishe, kabllot e tensionit të lartë, sistemet konvertorike etj.); dhe
- Mungesa e përfshirjes për monitorim dhe kontrollë të disa nënstacioneve në kuadër të infrastrukturës të SCADA/EMS.

**Mundësitë**

Mundësitë e KOSTT-t janë:

- Tregu i përbashkët Kosovë – Shqipëri progresi i funksionalizimittë bursës ALPEX;
- Integrimi në tregun rajonal dhe Pan Evropian të energjisë elektrike;
- Ofrimi i kapaciteteve  për shërbimet telekomunikuese dhe shërbimeve tjera;
- Zhvillimi i kapaciteteve interkonektive në përputhje me strategjinë e energjisë 2022-2031;
- Sektori i energjisë  i organizuar në përputhje me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së; dhe
- Digjitalizimi, automatizimi, rrjetet e mençura (Smart grid) dhe teknologjitë e avancuara.

**Kërcënimet**

Nga ana tjetër, KOSTT-i ballafaqohet me një numër të kërcënimeve, siç janë:

- Obstruksionet e EMS dhe TSO-ve të tjera ndaj KOSTT it në procesin e integrimeve rajonale dhe mekanizmat tjerë relevant ndërkombëtare;
- Zhvillimet globale si ndryshimet klimatike, pandemitë, konfliktet dhe krimet kibernetike;
- Dëmet e shkaktuara nga palët e treta në asetet e transmetimit, mungesa e sigurimit të aseteve të KOSTT-it;
- Ekspozimi ndaj rreziqeve të cilat rrjedhin nga kontestet gjyqësore;
- Procedurat e tej zgjatura të sigurimit të lejeve ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës së transmetimit;

- Rrisku rregullator në në vlerësimin dhe aprovimin e shpenzimeve respektivisht të hyrave të cilat nuk pasqyrojnë çmimet e tregut dhe nuk përcjellin trendin e zhvillimit të KOSTT në të gjitha fushat dhe përgjegjësit që i mbanë si TSO.
- Mosfunksionimi i tregut të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon;
- Menaxhimi i Fondit të BRE-ve dhe llogarisë balancuese për shkak të riskut të mos pagesave nga palët;
- Pengesat në implementimin e udhërrëfyesit aksional të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe e ajo e Serbisë ;
- Vazhdimi i pamundësimit të alokimit të kapaciteteve transmetuese KOSTT-EMS për shkak të refuzimit të EMS;
- Mundësia e kufizuar e rekrutimit të stafit profesional si pasojë e mungesës së ekspertëve;
- Mungesa e mjeteve financiare nga Qeveria e Kosovës; dhe
- Kërcënimet Ligjore si rezultat i padive dhe pretendimeve përmbarimore me vendime gjyqësore fuqiplota.

Faktorët e lartshënuar tregojnë se ekziston një bazë për një të ardhme të suksesshme për KOSTT-in, duke pasur parasysh përkrahjen e palëve të interesit që KOSTT-i të menaxhoj me sukses përballjet me sfidat dhe pengesat.

## 4. RRETHINA AFARISTE

Plani i Biznesit për periudhën 2023-2027 përmban këto aspekte themelore që ndërlidhen me rrethinën afariste, brenda së cilës operon KOSTT-i:

- Zhvillimi i sektorit të energjisë elektrike;
- Kornizat ligjore dhe rregullative; dhe
- Çështjet sociale dhe mjedisore.

### 4.1. Zhvillimi i sektorit të energjisë elektrike

#### 4.1.1. Historiku pas vitit 2000

Gjendja në sektorin elektroenergjetik në Kosovë ishte e rëndë pas luftës, si në prodhim , transmetim, po ashtu edhe në shpërndarje. Në këtë kohë filluan investimet emergjente të përgjithshme në sektorin elektroenergjetik, të përkrahura nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë. Për shkak të nevojave shumë të mëdha në tërë sektorin elektroenergjetik në fillim, rrjeti i transmetimit nuk u zhvillua konform rritjes së shpejt të konsumit në të kaluarën dhe që pasoi pas vitit 2000.

Që nga themelimi i KOSTT-it, në rrjetin e transmetimit janë kryer investime kapitale, kryesisht në zhvillimin dhe përforcimin e kapaciteteve të rrjetit të transmetimit, rivitalizim si dhe avancim të sistemeve mbështetëse. Bazuar në të gjithë indikatorët e matshëm të performancës të regjistruara në dekadën e fundit, si investimet e vazhdueshme me infrastrukturë të re të rrjetit të transmetimit, modernizimi i sistemeve mbështetëse të

Sistemit, rivitalizimi i nënstacioneve dhe linjave, kanë ndikuar në ngritje të vazhdueshme të sigurisë, besueshmërisë dhe performancës së operimit të sistemit të transmetimit. E gjithë kjo ka ndihmuar në stabilitetin e sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Kërkesat për ngritje të sigurisë së furnizimit dhe zhvillim të kapaciteteve të transmetimit me qellim të përkrahjes së ngarkesës në rritje, integrimin e gjenerimit nga burimet konvencionale dhe të ripërtëritshme, paraqesin faktorin kryesor për KOSTT që të vazhdoj me investimet në rrjet për vitet në vijim.

Në katër vendet që kufizohen me Kosovën (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), kapaciteti total netto i transferimit të importit (NTC) është 1,316 MW; totali i eksportit NTC është 1,175 MW. Duke i krahasuar këto shifra me totalin e kapaciteteve gjeneruese të instaluara netto, raporti i interkoneksionit është mbi 78%. Kërkesa e BE-së për këtë indikator është 10% për vitin 2020 dhe 15% deri në vitin 2030, që do të thotë se Kosova tashmë ka përmbushur objektivat e vitit 2030. Megjithatë, thellimi i bashkëpunimit me fqinjët, veçanërisht me Shqipërinë, është qenësor për të siguruar funksionimin efikas dhe të bazuar në treg të këtyre interkoneksioneve[2].

Operimi i KOSTT-it si zonë rregulluese në kuadër të bllokut rregullues AK (Shqipëri-Kosovë) nga 14 dhjetori 2020, si dhe themelimi i bursës Shqiptare ALPEX, në të cilën aksionar është edhe KOSTT.

## 4.2. Zhvillimet në KOSTT

### 4.2.1. Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të sistemit dhe transmetimit

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit të transmetimit gjatë periudhës 2025, do të jenë:

- Operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese e pavarur brenda Bllokut Rregullues AL-KS në përputhje me rregullat e ENTSO-E;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Sekondar(aFRR) me OST sipas planeve të parapara në BVEE 2025;
- Implementimi i Marrëveshjes për Rregullim Terciar (mFRR) me KESH dhe ndonjë tjetër POSH, sipas planeve të parapara në BVEE 2025;
- Implementimi i marrëveshjeve ndër- OST me OST-të fqinje;
- Implementimi i Tregut Balancues efektiv sipas legjislacionit në fuqi;
- Operimi i tregut të liberalizuar në përputhje me ligjin e ri të energjisë elektrike;
- Pjesëmarrja e KOSTT-it në marrjen e shërbimeve s’paku nga një Qendër Koordinative Rajonale për Siguri (Regional Coordination Center);

[2] *Strategjia e Energjisë 2022-2031(fq. 16)*

- Investimi në platforma softuerike, që mundësojnë pjesëmarrje në operimin paralel interkonektiv në nivel pan evropian si SMTA (short & medium term generation adequacy), CGM\OPDE (operational planning data environment), RSC (regional security coordination), EAS (ENTSO-EAwerness System), OPC (outage planning coordination), SCC (Security critical coordination), dhe rifreskimi i atyre ekzistuese;
- Trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin dhe shfrytëzimin e platformave softuerike për analiza të SCADA/EMS, Sistemit për Menaxhimin e Energjisë së Tregut, Kontrollit Frekuencë Fuqi-LFC, DACF- (Day Ahead Congestion Forecast - analiza e sigurisë së operimit një ditë para), IDCF (Intraday Congestion Forecast), paketi softuerik për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat;
- Avancimi i qendrës për leximin dhe menaxhimin e sistemeve matëse (AMR) për lehtësimin e kryerjes së aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më efiçient të sistemit të energjisë elektrike;
- Pjesëmarrja në procesin ENTSO-E të modelit vjetor 'Y-1' ;
- Zëvendësimi i infrastrukturës ekzistuese të sistemit SCADA/EMS konsiston në:
  - Ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit të transmetimit nga Qendra Nacionale Dispeçerike Kryesore dhe Emergjente;
  - Përfshirja e të gjitha objekteve elektroenergjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS konform PZHT;
  - Përfshirja e të gjitha ndryshimeve të realizuara në Nënstacione në SCS pas riparimeve dhe adaptimeve përkatëse;
  - Përmbyllja e krijimit të kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale konform "Inter TSO Marrëveshjeve" me TSO-të e shteteve fqinje;
  - Ndërlidhje e KOSTT në Electronic Highway (EH) të ENTSO-E si OST me drejta të plota me qëllim të shkëmbimit të të dhënave me ENSTO-E;
  - Përgatitja e infrastrukturës teknike për qasje në platformën e EAS (ENTSO-EAwerness System) në kuadër të ENTSO-E.

Investimet në zhvillimin e infrastrukturës që mundësojnë proceset e mësipërme, janë:

- Qasja në "electronic highway –EH";
- Dërgimi i të dhënave në kohë reale në Qendrën Koordinative të Evropës Kontinentale-Swissgrid;
- Dërgimi i të dhënave dhe monitorimi i një pjese të sistemit të transmetimit për çështje të sigurisë së operimit të sistemit në KOSTT dhe të sistemeve tjera: OST, MEPSO, CGES dhe EMS sipas kërkesave të ENTSO-E;
- Shkëmbimi i të dhënave në fazën planifikuese me OST tjera përmes platformës softuerike SMTA, CGM\OPDE,OPC;
- Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me TSO Evropiane përmes platformës softuerike EAS;
- Shkëmbimi i të dhënave me Zonat Rregulluese fqinje dhe Qendrën Koordinative;

- Shkëmbimi i të dhënave me Qendrën Koordinative Rajonale për Siguri (Regional Coordination Center)
- Alokimi i kapaciteteve në baza vjetore, mujore, ditore me OST-të fqinje;
- Operacionalizimi dhe shkëmbimi i të dhënave me ALPEX;
- Shkëmbimi i produkteve balancuese ndërkufitare; dhe
- Zëvendësimi i sistemit ekzistues SCADA/EMS, për t'i plotësuar kërkesat e theksuara si më lartë.

Edhe në të ardhmen, në KOSTT do të vazhdojë ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të domosdoshme, në mënyrë që të sigurohet furnizim stabil dhe i sigurt me energji elektrike.

KOSTT ka arritur që të ketë një siguri shumë më të lartë të operimit dhe mund të thuhet se performanca e arritur është mjaft e kënaqshme. Këtë e dëshmon edhe numri më i vogël i rënieve dhe intervenimeve, të cilat nga viti në vit kanë qenë në rënie dhe tani është arritur që të minimizohet numri i tyre.

Njëkohësisht, që të sigurohet operim sa më efikas i sistemit, është duke u vazhduar me investimet në rehabilitimin e nënstacioneve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre.

Meqenëse qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë së operimit të sistemit elektroenergjetik, përmes aktiviteteve të duhura në këtë drejtim, është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumta, KOSTT tanimë gjendet në fazën e mirëmbajtjes preventive.

Planin e mirëmbajtjes për periudhën 2023-2027, KOSTT e ka përpiluar bazuar në Rregulloren e Mirëmbajtjes, i cili parasheh të gjithë hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë në rrjetin e transmetimit, bazuar në praktikat më të mira profesionale si dhe sipas udhëzimeve të prodhuesve të pajisjeve elektroenergjetike, në mënyrë që të jenë funksionale dhe të garantojnë performancë të mjaftueshme për operim.

Prioritet i KOSTT-it mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat aplikohen në sistemet e avancuara, duke u bazuar në Rregullore dhe gjendjen e pajisjeve, në mënyrë që të kursehet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Përkundër këtij trendi të rehabilitimit në rrjetin e transmetimit, mbetet që të përmirësohet gjendja e gatishmërisë teknike të pjesës së rrjetit të transmetimit në pjesën veriore të Kosovës. Kjo duhet të bëhet fillimisht duke siguruar qasjen fizike të KOSTT-it në tërë asetet e veta atje, si kusht i domosdoshëm për realizimin e investimeve të nevojshme si dhe mirëmbajtjes adekuate.

Faza e investimeve atje do të përfshinte edhe realizimin e monitorimit dhe kontrollit të NS Vallaq dhe HC Ujman në kuadër të infrastrukturës së SCADA sistemit qendror të KOSTT.

### 4.2.2. Kapacitetet Gjeneruese

Energjia elektrike e prodhuar në Kosovë dominohet nga dy termocentrale relativisht të mëdha: TC Kosova A dhe TC Kosova B të cilat marrin pjesë me 87% në prodhimin total të energjisë elektrike në Kosovë sipas prodhimit të realizuar në vitin 2023, derisa disa kapacitete të reja të ripërtëritshme janë vënë në funksion në

vitet e fundit, veçanërisht Turbina të erës, Hidrocentrale të vogla dhe Parqe solare fotovoltaike. Shumica e konsumit të energjisë elektrike është përmbushur nga prodhimi i energjisë me bazë linjiti. Pas fillimit të operimit të PE Selaci 105 MW pjesëmarrja e BRE-ve në gjenerimin total është rritur dukshëm. Prodhimi nga dy parqet me erë Kitka dhe Selac ka arritur nivelin e prodhimit nga hidrocentralet. Në figurën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në % e prodhimit sipas teknologjive gjatë vitit paraprak 2023.




***Figura 2. Pjesëmarrja e prodhimit të energjisë sipas teknologjive në vitin 2023***

Parashikimi i gjenerimit të energjisë elektrike mbetet sfida kryesore në procesin e planifikimit të rrjetit transmetues, për shkak të pasigurisë së lartë të realizimit të tyre. Bazë e informacionit për parashikimin e gjenerimit në dhjetë vitet e ardhshme është marrë Strategjia e Energjisë 2022-2031, e cila do të jetë në harmoni me Planin Kombëtarë për Klimë dhe Energji, i cili aktualisht është duke u punuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto dy dokumente do të përcaktojnë objektivat e Kosovës për 5 dimensionet kryesore të parapërcaktuara nga Komuniteti Evropian:

- Siguria e Furnizimit
- Integrimi i Tregut
- Eficienca e Energjisë
- Dekarbonizimi i sektorëve të energjisë
- Hulumtimi, inovacioni dhe konkurrenca

Dimensioni i sigurisë së furnizimit përcakton objektivat afatmesëm dhe afatgjatë dhe standardet në lidhje me sigurinë e furnizimit, duke përfshirë zhvillimin e diversifikimit të burimeve të energjisë, infrastrukturës, akumulimit të energjisë, reagimit të kërkesës, gatishmërisë për të përballuar furnizimin e kufizuar ose të ndërprerë të një burimi të energjisë, dhe ndërtimin e burimeve të brendshme alternative. Në kuadër të këtij dimensioni përfshihen edhe projeksionet apo skenarët e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike. Bazuar në Strategjinë e Energjisë 2022-2031, dy njësitë e TC Kosova B do t'i nënshtrohen Rivitalizimit të

përgjithshëm duke mundësuar operimin e tyre me parametra optimal teknik si në aspektin e kapacitetit ashtu edhe në përmbushjen e nivelit të emetimit sipas standardeve Evropiane. Gjithashtu dy njësi të TC Kosova A (A3 dhe A4) parashihet të revitalizohen po ashtu në pajtueshmëri me Standardet Evropiane dhe si të tilla do të operojnë si rezervë strategjike gjatë periudhave kohore kur kërkesa është shumë e lartë (3 muaj në vit). Në anën tjetër, orientimet kryesore të Strategjisë së Energjisë janë në drejtim të dekarbonizimit të sektorit të energjisë, ku burimet e ripërtëritshme nga era dhe dielli si dhe eficienca e energjisë do të jenë shtyllat kryesore të dekarbonizimit. Procesi i daljes nga burimet fosile pritet të jetë gradual dhe afatgjatë (2030-2050), por ky lloj burimi për Kosovën do të jetë edhe për një periudhë kohore afatgjate shtylla kryesore e sigurisë së furnizimit. Burimet e energjisë nga fosilet do të zëvendësohen gradualisht me burime të ripërtritshme duke u shoqëruar edhe me zhvillimin e njësive fleksibile, stabilimenteve akumuluese të energjisë të cilat do të jenë të domosdoshme për të mundësuar integrimin e BRE-ve në sistem.

Në dhjetë vitet e ardhshme është planifikuar rritja graduale e kapaciteteve të BRE-ve me synim që deri në vitin 2031 kapaciteti i burimeve të reja nga era të shtohet për 600 MW (738 MW me kapacitetet ekzistuese) dhe gjithashtu 700 MW nga dielli prej të cilave 100 MW pritet të jenë e kategorisë “vet-konsum”. Integrimi i këtyre kapaciteteve nga burimet variabile kërkon planifikim të duhur të rrjetit të transmetimit si dhe sigurim të burimeve fleksibile për të arritur balancimin e sistemit në kohë reale. Në kuadër të kësaj, deri në 2027 pritet të instalohen rreth 170 MW Bateri Akumuluese me kohëzgjatje dy orësh në kuadër të përkrahjes nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes projektit Kompakt nga MCC. Bateritë do të mundësojnë balancimin e sistemit dhe integrimin e BRE-ve në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Ato do të ofrojnë rregullim sekondar (aFRR) dhe terciar (mFRR) për Operatorin e Sistemit. Gjithashtu do të përdorën për zhvendosjen e pikut përmes procesit optimal të mbushjes dhe zbrazjes.

Dimensioni i integrimit të tregut të energjisë përcakton objektivat në lidhje me konkurrencën e tregut, integrimin e tregut dhe bashkimin, vendosjen e fleksibilitetit në sektorin e energjisë, përfshirë zhvillimin e tregjeve afatshkurtra, konkurrencën në shërbimet e reagimit të kërkesës, dhe përdorimin e teknologjive të zgjuara dhe rrjeteve inteligjente. Operimi i KOSTT-it si zonë rregulluese në kuadër të bllokut rregullues AK (Shqipëri-Kosovë) nga 14 dhjetori 2020, si dhe themelimi i bursës Shqiptare ALPEX, në të cilën aksionar është edhe KOSTT-i do të krijoj kushte të favorshme për optimizimin e operimit të dy sistemeve elektroenergjetike dhe reduktimin e kostove operuese të dy sistemeve. Dy sistemet komplementare njëra me tjetrën kanë potencial të madh për përkrahjen e sektorit të energjisë elektrike, krijimin e tregut konkurrues dhe transparent si dhe rritjen e sigurisë së furnizimit për të dy vendet. Tregu i përbashkët do ta bëjë dukshëm më të lehtë integrimin e BRE-ve në rrjet, pasi që nevojat për rezerva rregulluese do të reduktohen, ndërsa do të rritet mundësia e krijimit të tregut për shërbime ndihmëse dhe zgjerimit të tij.

Një dimension tjetër shumë i rëndësishëm është efiçienca e shfrytëzimit të energjisë, e cila do të ndihmoj sektorin e energjisë në reduktimin e kërkesës për energji.

Dimensioni i de-karbonizimit ndërlidhet me dimensionet paraprake dhe faktori kryesor që e mundëson këtë është krijimi i kushteve për sistemin energjetik dhe elektroenergjetik për integrim gradual të burimeve të ripërtëritshme dhe përmirësimi i efiçiencës së shfrytëzimit të energjisë.

E tëra mund të realizohet nëse vendi mundëson kushte të favorshme për hulumtuesit e rinjë, inovacionet dhe konkurrencën e mirëfilltë. Resurset humane janë çelësi i suksesit.

Implementimi i të gjitha këtyre projekteve domosdo kërkon ndryshim të infrastrukturës të sistemit SCADA/EMS&SCS, e sidomos pjesa e EMS, me qëllim të adaptimit të këtij sistemi dhe përshtatjes ndaj kërkesave të ENTSO-E, implementimit të standardit IEC61970. Prandaj, sistemi ekzistues SCADA/EMS duhet të zëvendësohet në këtë periudhë pesë vjeçare me një sistem të ri që plotëson kërkesat e cekura si më lartë.

## 4.3. Zhvillimet kryesore nga aspekti i operimit të tregut

### 4.3.1. Liberalizimi i tregut dhe mundësit e integrimit në tregun e përbashkët rajonal

Ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë elektrike në Kosovë është funksionimi i tregut efektiv konkurrues në sektorin e energjisë elektrike dhe integrimi në tregun e përbashkët rajonal.

Me miratimin e legjislacionit të ri të sektorit të energjisë elektrike në vitin 2016, Kosova ka nisur liberalizimin e tregut të energjisë që i hap rrugën thellimit të reformës në këtë sektor. Në këtë aspekt është përshtatur legjislacionin sekondar për tu harmonizuar me legjislacionin e ri. KOSTT ka rishikuar rregullat e tregut të cilat janë dërguar për miratim tek ZRrE dhe ka përpiluar procedurat e nevojshme për të mbështetur proceset në këtë drejtim.

Përkundër masave të ndërmarra drejt liberalizimit të tregut në Kosovë, deri tani mungon konkurrenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë disa furnizues të licencuar për furnizim në tregun me pakicë të energjisë elektrike në Kosovë, tregu mbetet në nivel zhvillimi jo të knaqshem.

Aktualisht në tregun e energjisë elektrike janë vetëm pesë konsumatorë të parregulluar të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmetimit (Ferronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse SharriCemi, Trepça, PEE Selaci dhe PEE Kitka në nivelin 110kV), ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë furnizohen me çmime të rregulluara dhe janë pjesë e grupit të konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Gradualisht sipas afateve të përcaktuara nga ZRrE edhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV duhet të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të jenë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal.

Integrimi në tregun e përbashkët rajonal është mundësi e mirë për optimizimin dhe shfrytëzimin e burimeve më të lira të energjisë dhe pritet të japin efekte zbutëse sa i përket problemit të furnizimit, duke pasur parasysh që sistemi i transmetimit të Kosovës ka kapacitete të transmetimit interkonektiv të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare. Integrimet në tregjet rajonale janë obligim që kërkohet të përmbushet nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe njëra ndër objektivat kryesore të përcaktuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës. Gjithashtu integrimi rajonal është ndër objektivat e rëndësishme të KOSTT-it që përkundër angazhimeve të vazhdueshme në këtë drejtim, edhe më tutje vazhdon të ballafaqohet me shumë pengesa drejt integrimit në mekanizmat rajonale.

## 5. LIBERALIZIMI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Me udhëzimin e ZRrE-së për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë, është përcaktuar mënyra, kushtet dhe koha e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, në nivelin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Nga 1 prill 2017, tregtimi me shumicë i energjisë elektrike bëhet në çmime të de-rregulluara kurse de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale, duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale.

Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE dhe obligimeve që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. KOSTT (Operatori i Tregut) mirëmban Llogaritë energjetike për secilën palë të regjistruar në Rregullat e Tregut për çdo periodë të barazimit përfundimtar (për çdo orë) për energjinë e nominuar (kontraktuar) si dhe energjinë e matur dhe obligimet financiare të llogaritura për çdo periodë të barazimit përfundimtar (proces i barazimit energjetik dhe financiar). Në bazë të dhënave nga këto llogari krijohen raporte të cilat përdoren si bazë për faturimin e ndërsjellë mes palëve në treg si dhe për faturimin e pagesës së jobalanceve. Krijimi i llogarive për palët përgjegjëse për balancë ka mundësuar që, nga 1 qershor 2017 të fillojë implementimin e mekanizmit balancues, ku të gjitha palët të cilat dështojnë të përmbushin obligimet e tyre sipas nominimeve (obligimeve kontraktuale) paguajnë ose paguhen nga llogaria balancuese për energjinë e jobalancit me çmimin e jobalancit.

KOSTT si Operator i Sistemit Të Transmetimit, bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike (Neni 19 dhe 23), është përgjegjës për prokurimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në përputhje me procedurat transparente jo-diskriminuese dhe të bazuar në treg. KOSTT prokurimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit është duke e bërë nga KEK duke zbatuar kontratën për diferencë kurse pjesën e pa mbuluar nga prodhimi i KEK-ut, KOSTT nga data 1 Shkurt 2024 ka filluar të blej përmes Bursës Shqiptare të energjisë ALPEX.

### 5.1. Integrimi rajonal

KOSTT që nga dhjetori 2020 operon si Zonë e Pavarur Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues AK. KOSTT ka arritur të shënojë përparime drejt integrimit në mekanizmat rajonale. Si rezultat i angazhimeve të vazhdueshme KOSTT është:

1) Nënshkrues i Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E për punë paralele me Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale;
2) Themelues dhe aksionar i SEE CAO;
3) Pjesëmarrës në mekanizmin e pagesave dhe kompensimeve të transitit (ITC) në kuadër të ENTSOE;
4) Aksionar dhe bashkëthemelues i Bursës së Energjisë Elektrike (ALPEX) me Operatorin e Transmetimit të Shqipërisë; dhe

5) Nënshkrues i Memorandumit në nivel rajonal me katër OST-të e regjionit KOSTT, OST, MEPSO dhe IPTO rreth Bashkimit të Tregut (Marcet Copuling).

Nënshkrimi i Marrëveshjes së kyçjes me ENTSOE ka mundësuar që nga dhjetori 2020 KOSTT-i të ka mundësi që të alokojë kapacitetet e veta interkonektive përmes Zyrës për alokim të koordinuar të kapaciteteve. Hapja e Zyrës rajonale për alokim të koordinuar të kapaciteteve të transmetimit interkonektiv – CAO, do të lehtësojë dhe optimizojë procedurën e alokimit të kapaciteteve dhe vet procesin e shfrytëzimit të interkoneksionit. Vlen të theksohet se themelimi i kësaj Zyre është një hap drejt krijimit të tregut të përbashkët rajonal dhe integrimit në tregun unik Evropian, dhe në anën tjetër, afron Kosovën në përmbushjen e obligimeve të marra në kuadër të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë dhe procesit të integrimit në BE-së.

## 5.2. Menaxhimi i procesit të Ndërrimit të Furnizuesit

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, të drejtën e ndërrimit të Furnizuesit e ka çdo konsumator fundor, familjar ose jo familjar, ndërsa përgjegjësia për menaxhimin e procesit të ndërrimit të Furnizuesit i është dhënë Operatorit të Tregut. Këtë përgjegjësi Operatori i Tregut e ushtron sipas Rregullave të Tregut dhe Rregullës për Ndërrimin e Furnizuesit të miratuar nga ZRrE.

Në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të ZRrE-së të datës 18 janar 2017, janë përcaktuar edhe afatet kohore për de-rregullimin e çmimit të konsumatorëve fundorë. Bazuar në këtë udhëzim de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundorë do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme dhe atë bazuar në nivelin e tensionit në të cilin janë të kyçur konsumatorët dhe të drejtën për furnizim me energji elektrike në tregun konkurrues për të gjithë konsumatorët fundorë nga data e aprovimit të udhëzimit të ZRrE-së.

Bazuar në këto zhvillime te reja për mundësinë e konsumatorëve për ndërrimin e furnizuesit, KOSTT ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr veprimet e nevojshme për menaxhimin e procesit ndërrimit të Furnizuesit, bazuar në Rregullat e Tregut dhe në afatet kohore të përcaktuara në udhëzuesin e ZRrE-së. Megjithatë duke pasur parasysh afatin kohor brenda të cilit duhet të përfundohet procesi i transferimit të konsumatorit dhe numrin e konsumatorëve që kanë të drejtën e ndërrimit të furnizuesit e që në të ardhmen ky numër pritet të rritet, atëherë KOSTT duhet të filloj përgatitjet për sigurimin e një softueri që ky proces të kryhet në mënyrë automatike dhe të jetë i auditueshëm.

### 5.2.1. Objektivat kryesore dhe sfidat nga aspekti i operimit të tregut

KOSTT si operator i tregut do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe integrimin në mekanizmat rajonal. Në këtë drejtim aktivitetet e zhvilluara janë në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë, kërkesat që dalin nga

Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe MSA-së ndaj hapjes së tregut të energjisë, si dhe në pajtim me Direktivat e Komisionit Evropian.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të parashtruara si parakusht nga ENTSO-E, në harmoni me procedurën për tregtimin e energjisë elektrike të miratuar nga ZRRE, KOSTT ka bërë prokurimin e rezervave balancuese për Rezervën Manuale të Restaurimit të Frekuencës (mFRR) në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuara në treg. Duke pasur parasysh që ofruesit potencial të shërbimeve balancuese të kyçur në rrjetin e transmetimit të KOSTT nuk mund të ofrojnë sasinë e nevojshme të shërbimeve balancuese, ndërsa prokurimi i kapacitetit rezervë nga ofruesit e shërbimeve balancuese të kyçur në rrjetin e transmetimit të OST (Shqipëri) varet jo vetëm nga kapaciteti që disponojnë por edhe nga Kapacitetet Transmetuese Ndërkufitare të lira mes KOSTT dhe OST, sigurimi i sasisë së nevojshme të shërbimeve balancuese për Zonën LFC KOSTT mbetet sfidë edhe për vitin në vijim.

KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE, megjithatë mbetet sfidë konkurrenca në tregun me pakicë dhe implementimi i Mekanizmit Balancues në përputhje të plotë me Rregullat e Tregut. Nga gjithë konsumatorët në Kosovë, vetëm pesë konsumator të cilët janë të kyçur në rrjetin e transmetimit furnizohen me çmime të parregulluara. Ka pasur vështirësi në këtë kapërcim të menjëhershëm nga një treg i rregulluar në tregun e liberalizuar dhe për këtë arsye është paraparë që de-rregullimi i çmimit të konsumatorëve fundor do të bëhet në mënyrë graduale duke përdorur qasjen më të përshtatshme të mundshme me gjendjen aktuale.

Implementimin e marrëveshjeve për blerje të energjisë me BRE-të të cilat janë në operim ka filluar mirëpo rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të tyre paraqet sfidë në vete në aspektin e menaxhimit të fondit për BRE.

Në aspektin e integrimeve rajonale, më 1 prill 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, sipas së cilës, Kosova obligohet të përmbushë detyrimet që lidhen me integrimin në tregun e përbashkët rajonal (neni 114 i Marrëveshjes), ku ceket:“Në përputhje me acquis përkatëse të BE-së, Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e energjisë në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005. Bashkëpunimi do të zhvillohet me synim të integrimit gradual të Kosovës në tregjet Evropiane të energjisë “.

Në procesin e reformave në energji konform legjislacionit evropian, krijimi i tregut të përbashkët Kosovë-Shqipëri është një hap drejt integrimit në tregun pan-evropian në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB 6.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurt me energji elektrike KOSTT dhe OST bashkarisht kanë themeluar Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike-ALPEX.

Marrëveshja për themelimin e ALPEX është nënshkruar me 05.10.2020. KOSTT është aksionar së bashku me OST në bursën shqiptare APEX. Raporti i aksioneve ne ALPEX është: OST ka në disponim 57.25% të aksioneve dhe KOSTT disponon 42.75% të aksioneve. ALPEX nga data 11.04.2023 ka filluar operimin për Tregun Një Ditë Para në zonën e ofertimit të Shqipërisë, ndërsa nga data 31.01.2024 ka filluar operimin për Tregun e Një Ditë

Para në zonën e ofertimit të Kosovës dhe njëkohësisht me këtë edhe Bashkimin e Tregjeve Një Ditë Para Shqipëri – Kosovë. Procesi i bashkimit të dy tregjeve do të vazhdojë me funksionalizimin Bashkimin e Tregjeve Brenda Ditës Shqipëri – Kosovë në harmoni me planet e përpiluara të nga të dy vendet.

KOSTT-i do të vazhdojë të punojë me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit, të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentët e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përmbush obligimet që dalin nga ligjet e sektorit të energjisë elektrike në lidhje me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike;
- Përcjellë zhvillimet në drejtim të Modelit të Synuar të Tregut të Bashkimit Evropian rreth tregut të energjisë elektrike;
- Përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe Evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Bashkëpunojë Grupin e themeluar nga ENTSO-E që të monitorojë përmbushjen e standardeve të ENTSO-E nga ana e KOSTT;
- Vendos marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të e Evropës Kontinentale;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuojë në punën e SEE CAO (Coordinated Auction Office ) dhe të angazhohet që kapacitetet interkonektive të KOSTT të vazhdojnë te alokohen nga SEE CAO.

### 5.3. Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

Përfaqësimi i BRE-ve në miksin energjetik të Kosovës është rritur në një masë gjatë viteve të fundit. Objektivi kombëtar i BRE-ve në Kosovë është vendosur nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë në vitin 2012 dhe është konfirmuar përmes miratimit të akteve nënligjore nga Ministria e Ekonomisë. Në vitin 2020, Kosova ka tejkaluar objektivin e pjesëmarrjes prej 25% të BRE-ve. Megjithatë, pjesëmarrja e teknologjive të ndryshme të BRE-ve është e pabalancuar dhe ka dallime të konsiderueshme në pjesëmarrjen e BRE-ve në sektorë të ndryshëm. Në sektorin e ngrohjes, biomasa siguron rreth gjysmën e energjisë së nevojshme, ndërsa në sektorin e energjisë elektrike BRE-të marrin pjesë me vetëm 6.3%, të siguruar nga burimet ujore, të erës dhe në një masë të vogël nga dielli. Pjesa e BRE-ve në transport është shumë e vogël për disa arsye: dispozitat që lidhen me qëndrueshmërinë e biokarburanteve nuk janë transpozuar në kornizën ligjore dhe për pasojë nuk janë në përputhje me Direktivën 2009/28/EC. Kështu, biokarburantet nuk janë futur ende. Pjesëmarrja e automjeteve elektrike është shumë e ulët (0,05%), pasi deri në vitin 2021 janë importuar vetëm 157 automjete elektrike dhe hibride, krahasuar me rreth 333,000 makina që përdorin si lëndë djegëse naftë ose benzinë. Aktualisht nuk ka asnjë linjë hekurudhore të elektrizuar në vend[3]. Deri në vitin 2020 është përdorur tarifa nxitëse për të stimuluar zhvillimin e kapaciteteve të BRE-ve, kryesisht në sektorin e energjisë elektrike. Tarifa nxitëse është

[3] *Strategjie e Energjisë 2022-2031 (fq.17)*

pezulluar nga ZRrE-ja në vitin 2020 meqë mekanizmat mbështetës konkurrues u bënë më kosto-efektive për të nxitur zhvillimin e teknologjive të pastra, derisa aktualisht korniza ligjore po hartohet me qëllim që në të ardhmen të zbatohen skema mbështetëse transparente dhe kosto-efektive, siç janë ankandet. Tanimë vetëm se ka filluar procesi i zhvillimeve të kapaciteteve solare përmes ankandit të parë i cili pritet të përmbyllet në vitin 2023 për Parkun Solar në Kramovik me kapacitet 100 MW. Gjithashtu në proces të fazës fillestare të implementimit është edhe projekti i dytë Parku Solar SEGE me kapacitet 136 MW. Në anën tjetër edhe kompania publike e gjenerimit KEK ka në planet e veta diversifikimin e prodhimit përmes instalimit të Parkut Solar-KEK me kapacitet 100 MW dhe me mundësi të zgjerimit në vitet pasuese. Gjithashtu KOSTT deri me tani ka pranuar një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve për dhënie të informacionit Teknik për mundësinë e kyçjes së BRE-ve. Kryesisht dominon teknologjia e parqeve solare dhe ajo nga era.

Për të mundësuar rritjen e pjesëmarrjes së kapaciteteve të ripërtëritshme, fleksibiliteti është çështje kyçe në sektorin e energjisë elektrike. Aktualisht, vetëm kapacitetet e rezervës energjetike për mbajtjen nën kontroll të frekuencës (“frequency containment reserve”, FCR) (rezerva primare prej 5 MW) sigurohen nga termocentralet në Kosovë. Shërbimet e tjera ndihmëse (+/-25 MW aFRR dhe +143/-90 MW mFRR) ofrohen nga sistemi elektroenergjetik i Shqipërisë. Instalimi i Sistemit të Baterisë Akumuluese me kapacitet 170MW (340MWh) në kuadër të programit Compact të MCC, i cili pritet të implementohet në 2028 do të jetë tejet i rëndësishëm për të siguruar stabilitet të rrjetit në aspektin e rregullimit frekuencë-fuqi, duke mundësuar integrim më të lehtë të BRE-ve sipas Objektives së Strategjisë së Energjisë 2022-2031.

## 6. IMPLEMENTIMI I ARANZHMANEVE TË REJA OPERATIVE

Operimi si Zonë Rregulluese përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve të interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E. Për të performuar me sukses operimin e zonës rregulluese KOSTT në kuadër të AK LFC Bllokut rregullues, duhet të arrihen këto objektiva:

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si zonë rregulluese e pavarur dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me:
    - analizën e sigurisë së punës së sistemit një ditë para dhe gjatë ditës;
    - nominimin e programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të automatizuar përmes softuerëve adekuatë; dhe
    - krijimin e modelit referent të rrjetit për SEE të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, freskimi i planit të ri mbrojtës konform rrethanave zhvillimore, alokimin e kapaciteteve ndërkufitare në të gjithë kufijtë elektrik të Kosovës dhe llogaritja e kongjestioneve.

KOSTT duhet të zhvilloj të gjitha aktivitetet e nevojshme në plotësimin e kërkesave të paraqitura në Katalogun e Masave nga grupi i ekspertëve në kuadër të Projekt Group (GP KOSTT) i krijuar nga ENTSO-E/RGCE për

monitorimin e përformimit të KOSTT. Kërkesat janë kryesisht teknike, që ndërlidhen me sigurinë e operimit të sistemit, shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kritereve nga SOGL dhe SAFA.

Objektivat e monitorimit nga ENTSO-E janë:

- Siguria e operimit të sistemit elektroenergjetik nga aspekti i rrjetit;
- Siguria e Shërbimeve Ndihmëse;
- Mundësimi i balancimit i Sistemit në kohë reale;dhe
- Ndryshimet e nevojshme rregullative që kërkohet nga paketi i tretë i legjislacionit të Komisionit Evropian për Energji.

### 6.1. Korniza rregullative dhe tarifat

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE).

Korniza ligjore e zhvilluar për sektorin e energjisë është në pajtim me praktikat e mira të BE-së dhe siguron funksionimin e një autoriteti të pavarur rregullativ për energji, funksionim të licencuar të gjithë sektorëve kryesor energjetik, qasje jo diskriminuese dhe transparente ndaj palëve të treta dhe krijimin e kushteve për një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike në Kosovë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar në qershor të vitit 2016 ligjet e reja për sektorin e Energjisë (Ligjin për Energjinë 05/L-081, Ligjin për Energjinë Elektrike 05/L-085 dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë 05/L-084), të cilat përcaktojnë rregulla dhe masa për funksionimin e sektorit të energjisë, për të garantuar furnizim të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike dhe në përputhje me direktivat dhe rregulloret evropiane për sektorin e energjisë.

Duke u mbështetur në kërkesat e reja që dalin nga këto ligje dhe korniza rregullative e nxjerrë nga ZRrE, KOSTT ka rishikuar dhe ka përgatitur pothuajse të gjitha dokumentet duke u siguruar që ato të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesat e reja ligjore dhe rregullative. Në përputhje me kërkesat për promovim dhe zhvillim të transparencës, të dala nga dispozitat evropiane dhe gjithashtu duke plotësuar edhe detyrimet për publikimin e dokumenteve dhe të dhënave me qëllim të rritjes së transparencës dhe mos diskriminimit të palëve të treta, në përputhje të plotë me kërkesat e Rregulloreve të Bashkimit Evropian (EU) 543/2013 dhe (EU) 714/2009, KOSTT ka përpiluar dhe ZRrE ka aprovuar Rregullën për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike. Duke u mbështetur në obligimet e dalura nga kjo Rregull, është bërë ridizajnimi i webfaqes me qëllim të krijimit të kushteve për zbatimin e dispozitave, që nënkupton krijimin e bazës strukturore me qëllim të publikimit të të dhënave të energjisë elektrike me qëllim që ti kontribuohet zhvillimit të një tregu transparent të energjisë elektrike. Lidhur me këtë ZRrE dy herë në vit bën vlerësimin e transparencës në raport me Rregullën për Publikimin e të Dhënave të Tregut të Energjisë Elektrike.

Republika e Kosovës si Palë Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, obligohet të transpozoj në legjislacionin e vet kombëtar dispozitat e ligjeve të Bashkimit Evropian, që rregullojnë sektorin e energjisë, veçanërisht pakon e

fundit të ligjeve të tilla që u konsoliduan në Pakon e Energjisë së Pastër. Në kuadër të kësaj Ministria e Ekonomisë ka dërguar Koncept Dokumentin për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë, dhe KOSTT ka kontribuar duke komentuar edhe gjatë vitit 2024, duke qenë pjesëmarrës në draftimin e ligjeve të reja të energjisë duke bërë transpozimin e Direktivave dhe Rregulloreve të BE-së, dhe më pastaj duke harmonizuar legjislacionin sekondar aktual të KOSTT me aktet e reja ligjore në përputhje me Pakon e energjisë së pastër.

Dokumentet kryesore rregullative të cilave u përmbahet KOSTT-i gjatë zhvillimit të veprimtarisë së vet të licencuar dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e KOSTT-it janë:

- Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike;
- Licenca e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike;
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Marrëveshja e Kyçjes KOSTT- ENTSO-E;
- Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Taksave të Kyçjes;
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operimit të Sistemit;
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut;
- Rregullat e Tregut;
- Kodi i Rrjetit të Transmetimit;
- Kodi i matjes; dhe
- Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovë.

Në planet e rregullta të punës, KOSTT ka gjithashtu edhe rishikimin e dokumenteve varësisht prej kërkesave ligjore dhe konkluzioneve të nxjerra nga procesi i monitorimit intern të implementimit të kornizës rregullative, gjegjësisht Kodit të Rrjetit, i cili realizohet çdo vit. Në rastin kur ndryshimet e nevojshme identifikohen për Kodet Teknike, atëherë këto ndryshime bëhen në bazë të procedurës të miratuar nga ZRrE Procedura për Menaxhimin e Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO).

Gjatë vitit 2024 dhe 2025 duhet të bëhen transpozimet e Pakos së re të Kodeve të Rrjetit dhe Udhëzuesve (SOGL, CACM, FCA, EBGL dhe EER) e adaptuar nga Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë. Transpozimet do të bëhen sipas dakordësimit përmes zhvillimit të metodologjive apo integrimit dhe konsolidimit të Kodeve të Rrjetit të BE-së në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Kodin e Matjes, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Rregullat e Tregut, përmes konsulencës.

KOSTT-i edhe më tutje është në pamundësi për t'i implementuar të gjitha dispozitat/kërkesat të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, dhe konsultohet me stafin relevant në baza vjetore nëse edhe më tutje duhet të përfshihen ato dispozita në Raportin e Derogimeve. Derogime kemi edhe për një dispozitë të Kodit të Matjes dhe një

Dispozitë nga Licenca e OST-së në lidhje me sigurimin e aseteve të transmetimit, të cilat dispozita përfshihen në kërkesa të ndara për derogime për implementim të dispozitave përkatëse të cilat i proceson për aprovim në ZRrE.

Në kuadër të procesit të implementimit të kornizës rregullative të sektorit të energjisë që ndërlidhet me procesin e Integrimeve Evropiane, KOSTT vazhdimisht ka qenë dhe është pjesë e procesit të raportimit mbi implementimin e masave ligjore dhe zbatuese të përfshira brenda Agjendës Evropiane për Integrim dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), Raportimet në kuadër të Nënkomitetit për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, Raportimet vjetore kombëtare kundrejt Komisionit Evropian lidhur me progresin vjetor të vendit dhe Planin Vjetor të Punës së Qeverisë së Kosovës (PVPQ) janë si pjesë ndërlidhëse me këtë proces integrues.

Nga perspektiva e planit të biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave të lejuara dhe tarifave.

Zyra e Rregullatorit për Energji në përputhje me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së), i përcakton KOSTT-it të Hyrat Maksimale të Lejuara. Këto janë të hyra tavan, pavarësisht vëllimit të energjisë së transmetuar, që vendosen për periudhë pesëvjeçare.

Si përgjigje ndaj çështjeve të cekura më lartë, KOSTT do të zhvilloj këto aktivitete:

- Të përgatitet procesi për Përshtatjet e Rregullta dhe për çdo ri-hapje të mundshme të kontrollit të çmimit, ku gjatë përshtatjeve të rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të hyrave të lejuara maksimale, të cilat bëhen para çdo viti të ardhshëm relevant;
- Të përgatitet sipas kërkesave për ndryshime në metodologjinë e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit si dhe për diskutime me ZRRE-në gjatë procesit për Përshtatjet e Rregullta;
- Të kryejë analiza tarifore me qëllim që të identifikojë mundësitë për përmirësime të produktivitetit dhe efikasitetit;
- Të monitorojë implementimin e planit investiv me qëllim të promovimit të implementimit efiçient të planit zhvillimor nga i cili do të nxirren edhe stimulues në të hyrat e veta, etj;
- Përmbushjen e obligimeve ndaj Licencës për Operim të Infrastrukturës telekomunikuese (shërbimet nga komercializimi i fibrave Optike), bazuar në ligje, Autorizime/licenca dhe në Rregullore të miratuara nga Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP). Në këtë drejtim, përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar nga ligjet e Kosovës për telekomunikime;
- Ligji për Komunikimet Elektronike nr. 04 / L-109, dhe Autorizimet e lëshuara nga ARKEP;
- Autorizimi Nr. 208/L/13 për Operim të shërbimeve të infrastrukturës telekomunikuese të KOSTT-it. Me këtë KOSTT-it i lejohet krijimi, mirëmbajtja, dhënia me qira, bashkë shfrytëzim dhe shitje e shërbimeve përmes infrastrukturës telekomunikuese në Republikën e Kosovës;
- Sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, në përputhje me dispozitat e Nenit 16 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe Rregullores Nr.25 për Autorizimet e Përgjithshme (ref. ARKEP nr.

prot.015/B/14) dhe Vendimit Nr.581 (ref. ARKEP nr. prot. 002/B/15), KOSTT është regjistruar në Regjistrin e ndërmarrjeve për Ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;

- Ofrimi i rrjetit fiks (në nivel Nacional);
- Ofrimi i shërbimeve të linjave me qira (fibër optik të pa-ndriçuar dhe linja tjera me qira); dhe
- KOSTT ka të drejtë në shtrirjen e rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve të dhënies së kapaciteteve në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe dhënien dhe marrjen e kapaciteteve, respektivisht interkoneksionin me shtetet tjera, përfshirë Republikën e Shqipërisë.

### 6.2. Projektet e reja të ndërlidhura me bizneset jo të rregulluara

Duke konsideruar perspektivën për angazhim në projekte të reja (biznese tjera jo të rregulluara), KOSTT-i duhet të ketë parasysh bazën ligjore për angazhimin e KOSTT-it në aktivitetet tjera brenda sektorit të energjisë në Kosovë dhe planifikimin fondeve për investime.

Mundësia më evidente për KOSTT-in është rritja e të hyrave nga ofrimi i shërbimeve telekomunikuese, përkatësisht paraqitja në treg e kapaciteteve tepricë të fijeve optike, si biznes sekondar. Këto kapacitete telekomunikuese, rrjeti fibër optik, janë ndërtuar me qëllim të zhvillimit të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të operimit të sistemit të transmetimit (SCADA/EMS), mbrojtjeve nga distanca, matjeve komerciale dhe për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Andaj, funksioni primar i sistemit telekomunikues të KOSTT-it është dhe do të jetë edhe në të ardhmen mbështetja telekomunikuese për biznesin kryesor të KOSTT-it.

Lidhur me ndarjen/bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës ndërkufitare të telekomunikacionit, përmes rrjetit transmetues të KOSTT dhe linjave interkonektive, Banka Botërore është duke mbështet aktivitetet në kuadër të nismës Balkans Digital Highway(BDH). Gjatë vitit 2023 do të përgatitet studimi “Studime Fizibiliteti për Rrjetin Autostrada Digjitale Ballkanike” i cili studim mbështet fillimin e një projekti për ndarjen/bashkë shfrytëzimin e infrastrukturës ndërkufitare të telekomunikacionit, respektivisht të fibrave optik, për ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Sipas planit, mbështetja e BB do të vazhdoj për përgatitjen e dizajnit të detajuar të projektit dhe dokumentacionit për tenderim. Gjithashtu, mbështetje e nevojshme është planifikuar në drejtim të ngritjes se kapaciteteve për ofrim të shërbimeve të ndarjes/bashkë shfrytëzimit të infrastrukturës rajonale përmes dialogut rajonal dhe ndërtimit të kapaciteteve njerëzore brenda OST-ve.

## 7. ÇËSHTJET SOCIALE DHE MJEDISORE

Barazia gjinore është një çështje me të cilën KOSTT-i përballet së bashku me homologët e vet në shumicën e vendeve evropiane, dhe në këtë aspekt, Bordi i Drejtorëve të KOSTT i ka aprovuar politikat përkatëse për mos diskriminim gjinor. Në këtë aspekt, KOSTT kujdes të posaçëm i ka kushtuar barazisë gjinore në të gjitha fushat e biznesit si në rekrutimin, promovimin, trajnimin apo fushat tjera ku barazia gjinore vjen në shprehje.

KOSTT-i përveç promovimit të barazisë gjinore, gjithashtu e promovon edhe barazinë dhe jo diskriminimin e aspekteve tjera si: barazia, religjioni, baza etnike, dhe përfshirjen e komuniteteve në KOSTT.

Njëra nga objektivat strategjike e definuar në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për ta plotësuar përgjegjshmërinë nga aspekti social, si një nga objektivat e saj të vendosura, KOSTT do të sigurojë se do të kujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe do të përgatiten projekte konkrete për mbrojtjen e shëndetit për punëtorët e saj.

Derisa të hyj në fuqi Ligji për sigurimin shëndetësor, KOSTT do të mbulojë punëtorët e vet me sigurimin shëndetësor suplementar. Po qe se do të vijë deri te hyrja në fuqi e këtij Ligji, KOSTT do të ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për implementimin e tij. Në këtë drejtim, KOSTT është i përkushtuar që edhe pas futjes në fuqi të sigurimit shëndetësor shtetëror, të vazhdoj skemën për sigurim aksidental të punëtorëve, konform vendeve të punës me rrezikshmëri dhe nevoja të veçanta pune. KOSTT është i përkushtuar që edhe pas futjes në fuqi të sigurimit shëndetësor shtetëror të vazhdoj skemën për sigurim aksidental të punëtorëve, konform vendeve të punës me rrezikshmëri dhe nevoja të veçanta pune.

Fokusi i KOSTT-it mbi sigurinë dhe shëndetin në punë bazohet në:

- Politikën mbi sigurinë në punë duke shprehur angazhimin në promovimin e parandalimit të aksidenteve për të gjithë punonjësit, duke përfshirë edhe ata të kontraktorëve, konform dokumentacionit intern në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë: "Dokumentet për Vlerësimin e Rrezikut në vendin e punës dhe Rregullat dhe masat e sigurisë gjatë punëve në objektet elektroenergjetike";
- Monitorimi dhe implementimi i kontrolleve sistematike mjekësore për të gjithë punëtorët konform kërkesave të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut në vendin e punës për punëtorët dhe pajisjet dhe përcaktimin e masave preventive paraprake për eliminimin apo parandalimin e tij;
- Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe bashkëpunimin me sektorët përkatës për përmirësim të vazhdueshëm të sigurisë;
- Mbështetjen dhe informimin e vazhdueshëm për interpretimin e dispozitave ligjore;
- Inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të punëve të brendshme dhe të kontraktura si dhe aktivitet intensive të monitorimit mbi aplikimin e duhur dhe të plotë të procedurave si forma të verifikimit të brendshëm;
- Përmbushjen e kërkesave që dalin nga certifikimi me standardin OHSAS 18001:2004 dhe avancimi i vazhdueshëm i kritereve që dalin prej tij për një menaxhim me cilësor të sigurisë në punë krahas sistemit të integruar të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë;
- Për menaxhimin e cilësisë dhe mjedisit;
- Vlerësimin e performancës së sigurisë si pjesë e integruar në sistemin e monitorimit të aktiviteteve;
- Kontrollimin dhe vlerësimin e besueshmërisë së mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse;
- Informacione intensive dhe të vazhdueshme përfshirë edhe aktivitete trajnuese për gjithë personelin për nocionet kryesore të sigurisë dhe risive nga kjo fushë, duke shfrytëzuar organizimin e takimeve,

prezantimeve, programeve trajnuese, sipas dokumentit: “Informimi, edukimi dhe trajnimi praktik për sigurinë dhe shëndetin në punë”;

- Kërkesën ndaj kontraktorëve gjatë kontratave për deklarimet për përmbushjen e trajnimeve dhe informimit për gjithë personelin e pranishëm në vendin e punës, përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse dhe mbi rreziqet. Për pozitat specifike (projekt menaxher, inxhinier terreni etj.) certifikata trajnimi, derisa për furnizimet, procedurë e miratuar për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Mirëmbajtja dhe monitorimi i përgjithshëm i sistemit për mbrojtje nga zjarri dhe raste emergjente;
- Avancimin e vazhdueshëm të sistemit për mbrojtje nga zjarri dhe raste emergjente;
- Angazhimin në procesin e zhvillimit të projekteve të reja dhe rehabilitimin e objekteve ekzistuese, nga përgatitja e termave të referencës, deri te pranimi teknik.

KOSTT vlerëson si një prioritet të lartë mbrojtjen e mjedisit në Kosovë dhe më gjerë. Aplikimi i sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe veprimi konform kërkesave që dalin nga certifikimi sipas normës ISO 14001:2015 do të ndikojnë për përparim të vazhdueshëm të raporteve ndaj mjedisit.

Certifikimi me standardin ISO 14001:2015 është një mundësi shtese në përmbushjen e kërkesave dhe avancimin e vazhdueshëm të kritereve që dalin prej tij për një menaxhim me cilësor të mjedisit në punë, krahas sistemit të integruar të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë.

Me aktivitetet për aplikimin e sistemit të udhëheqjes me mjedisin, KOSTT ka filluar që në vitin 2009. Norma Ndërkombëtare ISO 14001:2001 sot është standardi më i përparuar për udhëheqjen me mjedisin, i cili është i zbatueshëm në secilën ndërmarrje e cila dëshiron ta aplikojë, mirëmbajë dhe pandërprerë ta përmirësojë sistemin e vet të udhëheqjes me mjedisin. Zbatimi i një qasjeje të tillë nga ana e ndërmarrjes, është proces vullnetar. Kujdesi i veçantë, mjedisit i kushtohet edhe gjatë implementimit të projekteve. Në procesin e planifikimit të projekteve varësisht sipas kërkesave ligjore, bëhen studimet e ndikimeve në mjedis të objekteve energjetike. Mirëpo veprimtaria e KOSTT-it nuk konsiderohet ndër veprimtaritë që janë me potencial të lartë për ndotjen e mjedisit.

Dispozita e rëndësishme e normës Ndërkombëtare ISO 14001 përfshinë obligimin e ndërmarrjes në politikën personale të udhëheqjes me mjedisin, me të cilën ndërmarrja përcakton strategjinë dhe qëllimet e veta në raport ndaj mjedisit, duke realizuar synimet e veta në mënyrë që ato të jetësohen në praktikë. Me sistemin e udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë parashtrohen kritere të barabarta, brenda të cilave ka mundësi të planifikohen, zbatohen, verifikohen dhe të rishqyrtohen të gjitha ndikimet e mundshme në mjedis dhe masat e mbrojtjes së mjedisit në të gjitha segmentet e afarizmit në një ndërmarrje.

Parimet themelore të lidhura me udhëheqjen e mjedisit përfshijnë rinjohjen e aspekteve dhe ndikimeve në mjedis në bazë të cilave parashtrohen synimet dhe programet, përcillen rezultatet e matshme të zbatimit të tyre, andaj në mënyrë periodike ndërmerren aktivitete për përmirësim permanent.

Me qëllim të kompensimit të shpyllëzimit përgjatë linjave të tensionit të lartë, për të mbajtur sigurinë dhe funksionimin normal të linjave, KOSTT planifikon në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale të përkrah mbjelljen e drunjëve dhe gjelbërimin e sipërfaqeve.

Nga certifikimi me sistemin e udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë, priten efekte pozitive, siç janë: përmirësimet e gjendjes në perimetrin mjedisor dhe të sigurisë vetanake, investimet më racionale në projektet e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë, si dhe shumë efekte tjera të ngjashme. Nga ana tjetër, synohet një avancim në raport me institucionet kompetente, duke bërë ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes mbi mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në tërësi, si dhe duke përmirësuar pasqyrën afariste ndaj publikut të gjerë, gjë që i kontribuon përmbushjes së synimeve themelore afariste të KOSTT-it.

KOSTT gjatë vitit 2018 ka përfunduar me matjen e FEM (rrezatimeve jo jonizuese) dhe matjen e ndotësve fiziko-kimik dhe kushteve mikroklimatike në vendin e punës në nënstacionet dhe linjat elektrike të tensionit të lartë, si përkushtim për një mjedis të shëndosh dhe përmbushje të kërkesave ligjore sipas Ligjit për Sigurinë dhe Shëndet në Punë, Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma dhe Ligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare.

Me këtë qasje KOSTT-i si ndërmarrje publike bëhet anëtar i përhershëm, i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm i mjedisit në të cilin vepron si dhe përmes sistemit që aplikon, me qëllim që ta përparojë cilësinë e jetës në mjedisin e drejtpërdrejtë, si dhe atë në nivelin global.

Gjithashtu implementimi i Standardin ISO 14001:2015 është një mundësi shtesë në përmbushjen e kërkesave dhe avancimin e vazhdueshëm të kritereve që dalin prej tij për një menaxhim me cilësor të mjedisit në punë, krahas sistemit të integruar të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë.

## 8. PLANI INVESTIV

### 8.1. Plani Zhvillimor dhe investiv i Rrjetit të Transmetimit (PZHIT&PIZHT)

KOSTT-i ka bërë identifikimin e projekteve nga Plani Zhvillimor 2023-2027 për investimet e domosdoshme, planifikimi i buxheti për vitin 2025, sigurimi i burimeve të financimit për projektet kanë për qëllim realizimin e objektivave strategjike të KOSTT-it.

Bazuar në Planin Zhvillimor dhe Investiv të Transmetimit (PZHIT) 2023-2027, KOSTT planifikon investimet për projektet kapitale sipas prioriteteve në:

- Përforcimet në rrjetin e transmetimit;
- Përkrahja e ngarkesës/nyjet e reja 220/110/35/10(20)kV;
- Ri-vitalizimi i rrjetit të transmetimit;
- Projektet përkrahëse për operimin e sistemit të transmetimit (menaxhim, kontroll, monitorim, matje, telekomunikim dhe TIK);
- Përkrahja e gjenerimit; dhe
- Përkrahja në integrimin në rrjetin e transmetimit të gjeneruesve me energji të ripërtëritshme.

Përgjithësisht, vlerësimet financiare të projekteve janë bazuar nga të dhënat e zhvillimeve të kaluara të projekteve të zhvilluara, nga prodhuesit, çmimet e kontratave (bazuar në ofertat e fundit të pranuara për

projektet e ngjashme në Kosovë), si dhe nga vlerësimet, studimet dhe raportet e tjera të bëra nga kompanitë konsultuese, si dhe ngjarjet me ndikim në kostot e zhvillimit të projekteve në aspektin global.

Investimet e planifikuar në Rrjetin e Transmetimit drejtpërsëdrejti ndikojnë në:

- Rritjen e kapaciteteve transmetuese nacionale dhe ndërkufitare duke eliminuar fytet e ngushta;
- Menaxhimin më efikas të sistemit elektroenergjetik, duke zbatuar teknologji të avancuara të monitorimit dhe kontrollit;
- Rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit transmetues;
- Rritjen e saktësisë së matjeve komerciale, zvogëlimin e humbjeve teknike në rrjet;
- Përmirësimin e profilit të tensionit që reflekton në kualitet të lartë të furnizimit me energji elektrike dhe mundësisë së përkrahjes së zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik dhe industrial të vendit;
- Plotësimin e kriterit N-1 që kërkohet sipas kodit të rrjetit dhe ENTSO-E; dhe
- Përkrahja e gjenerimit respektivisht gjeneruesve të energjisë së ripërtëritshme.

Vlera totale e planifikuar e buxhetit për vitin 2025 parashihet të jetë rreth 3mil euro për projektet e planifikuara nga Departamenti i Zhvillimit të Rrjetit dhe Projekteve, varet nga investimet e planifikuar me Kfw faza e VII me WBIF – grant dhe investimet e EU/IPA si grant.

## 8.2. Përshkrimi i disa projekteve më të rëndësishme

### 8.2.1. Projektet në vazhdimësi

**Statusi i Grupi i të projekteve të cilat kanë filluar gjatë viteve 2021-2023 janë dhënë si më poshtë:**

- **Ndërtimi i NS 110/35/10(20) kV Kastrioti (Ferizaj 3) me transormator 40MVA**

Bazuar në planin zhvillimor të rrjetit të transmetimit 2018-2022, ndërtimi i nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 i tipit GIS i hapur, si prioritet për përkrahjen e ngarkesës është planifikuar dhe realizuar nga Buxheti i KOSTT-it. Kontratë është nënshkruar në mars të vitit 2021, ndërsa punët implementuese kanë filluar në maj të vitit 2021, projekti është realizuar sipas kontratës brenda 24 muajve dhe ka përfunduar brenda 24 muajve, në maj të vitit 2023. Janë realizuar të gjitha testimet por fatëkeqësisht projekti nuk është energjizuar për shkak të vonesave të shkaktuar në realizimin e projektit të ndërlidhur të linjës 110kV, si pasojë e ankesave në gjykatë nga pronarët e tokave.

Për shkakë të ndërlidhshmërisë me projektin e linjës, projekti financiarisht nuk është përmbyllur por mbetët një buxhet i planifikuar në vlerë prej 17,000 € për vitin 2025.

Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV do të ndikoj në shpërndarjen e ngarkesës nga NS Bibaj në nënstacionin e ri, duke evituar rrezikun e rënies së transformatorëve dhe shkaktimin e sasive të mëdha të energjisë së padërguar tek konsumatorët, me efekt negativ për bizneset, industrinë dhe qytetarët.

**Përfitimet e pritshme nga projekti janë:**

- Furnizimi i besueshëm dhe kualitativ i konsumit të Ferizajit dhe rrethinës;
- Shkarkimi i ngarkesës së transformatorëve në NS Bibaj;
- Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes;
- Reduktimi i sasive të mëdha të energjisë së padërguar të konsumatori si rrjedhojë e eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes.

- **Ndërtimi i linjës/kabllos 110 kV për kyçje të nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaji3 (Kastrioti)**

Projekti është nënshkruar në maj 2021 dhe është dashur të përfundoj në maj të vitit 2023. Për shkak të vonesave në shpronësim dhe servitut dhe ankesave nga pronarët për trasenë e linjës, lënda është në proces gjygjësor. Kjo ka shkaktuar vonesa në marrjen e lejes ndërtimore dhe fillimin e implementimt të projektit sipas planit, prandaj KOSTT-i në marrëveshje me kontraktorin ka bërë amandamentimin e kontratës dhe shtyerjen e afatit deri në nëntor të vitit 2024, pa kompenzim financiar, në rast se nuk kemi ndryshim në aspektin e lejimit të ndërtimit projekti pritet të prolongohet deri në vitin 2025. Kjo ka shkaktuar vonesë në Energjizimin e Nënstacionit të ri 110/35.10(20)kV Ferizaji 3.

- **Ndërtimi i NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova**

Në listën e projekteve me prioritet nga këndvështrimi i KEDS-it, përkrahja e ngarkesës është ndërtimi i nënstacionit Fushë Kosova 110/10(20) kV në afërsi të nënstacionit ekzistues 35/10 kV, projekt. Kontrata e implementimit të projektit është nënshkruar në janar të vitit 2022. Projekti ka përfunduar sipas kontratës në fillim të vitit 2024 dhe tani është në afatin garantues.

Infrastruktura e linjave furnizuese të nënstacionit përfshinë linjë ajrore dyfishe me gjatësi 2.91 km (360mm2-AlÇe) dhe 1.23 km linjë kabllore dyfishe e llojit XLPE Al, 1000 mm2 është implementuar në kuadër të projekteve të kredituara nga BERZH.

Kontrata për Transformatorin është nënshkruar në prill të 2024 dhe pritet të përfundoj në mars 2025.

**Përfitimet e pritshme nga projekti janë:**

- *Furnizimi i besueshëm dhe kualitativ i konsumit të Fushë Kosovës;*
- *Shkarkimi i ngarkese së Transformatorëve në NS Prishtina 1 dhe NS Kosova A;*
- *Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes;*
- *Shfrytëzimi optimal i linjës së konvertuar (Kosova A - Lipjan – Ferizaj 2);*
- *Optimizimi i rrjedhave të fuqisë në linjat 110 kV që furnizojnë nënstacionet e Prishtinës si rrjedhojë e shkarkimit të transformatorëve në NS Prishtina 1 dhe NS Kosova A; dhe*
- *Reduktimi i sasive të mëdha të energjisë së padërguar të konsumatori si rrjedhojë e eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes.*

- **Furnizimi dhe instalimi i Transformatorit të Fuqisë 40MVA për NS Fushë Kosova**

Kontrata është nënshkruar 25.04.2024, kontraktori ka filluar me punët në teren dhe sipas kontratës projekti duhet të përfundoi në prill të vitit 2025. Furnizimi dhe instalimi i Transformatorit të fuqisë 40MVA për NS Fushë Kosova, do të ndikojn në Energjizimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20)kv Fushë Kosova.

- **Përgaditja e Dokumentacionit Ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën transmetuese 220kV**

Projekti ka si objektiv kryesore përgatitjen e Dokumentacionit Ndërtimor Projektues, për KOSTT (Autoriteti Kontraktues) për dizajnin Konceptual/ideor, Projektin Kryesor, si dhe të gjitha dokumentacionet tjera sipas ligjit, për nënstacionin të ri AIS "NS 220/35/10(20) kV – Malisheva" me linja përcjellëse 220kV, me qëllim të ndërtimit të suksesshëm të nënstacionit të ri 220/35/10(20) kV, sipas IEC standardev, Kodit të rrjetit , Kodit të pajisjeve elektrike dhe ligjeve rregullativave dhe ligjit për ndërtim (Ligji për Ndërtim Nr. 04/L – 110 , me plotësimet, udhëzimet administrative përkatëse, Ligji i prokurimit, Ligji për Planifikim Hapësinor, etj) në Kosovë të cilat janë në fuqi.

Kontrata për këtë projekt është nënshkruar me datë 30.08.2023, mirëpo për shkak të disa vonesave për arsye të mungesës së komunikimit ndërinstitucional ky projekt aktualisht është në proces të amandamentimit. Kompania kontraktuese ka përgaditur për KOSTT-in ( Autoritetin Kontraktues) komplet Dokumentacionit Ndërtimor Projektues (Projektit Ekzekutiv) për tenderim duke përfshirë të gjitha përshkrimet teknike dhe ato ndërtimore dhe kërkesat konform Ligjeve në fuqi në Kosovë dhe Standardeve Europiane, për ndërtimin dhe instalimin e nënstacionit të ri 220/35/10(20)kV me linjën ajrore përcjellëse.

Procesi i përgatitjes së dokumentacionit nënkupton dorëzimin e dokumentacionit në Ministri për marrjen e lejeve ndërtimore. Kontraktori ka përgaditur dokumentacionin ndërtimor projektues dhe bashkë me Autoritetin Kontraktues aplikojnë për marrjen e kushteve ndërtimore dhe Leje Ndërtimore. Projekti pritet të përfundoj në fund të vitit 2024.

- **Ndërtimit të Nënstacionit 220/35/10(20) kV – Malisheva me transformator 40MVA dhe linjat përcjellëse 220kV**

Projekti Malisheva është futur në listën e projekteve kapitale të cilat përkrahin ngarkesën dhe përforcojnë kapacitetet transmetuese të rrjetit.

Situata e furnizimit të rajonit të Malishevës është jo e mirë, pasi që ky rajon aktualisht furnizohet përmes linjës së vetme 35 kV nga NS Rahoveci. Distanca e madhe e kësaj linje krijon humbje të mëdha të fuqisë aktive dhe reaktive duke ndikuar negativisht në kualitetin e fuqisë elektrike të liferuar deri te konsumatori.

Niveli i tensionit 35 kV dhe niveleve tjera shpërndarëse gjatë ngarkesës dimërore është nën vlerat minimale të lejuara sipas kodit të shpërndarjes. Për të arritur një furnizim të qëndrueshëm dhe afatgjatë me energji elektrike për rajonin e Malishevës, është i nevojshëm ndërtimi i një nënstacioni 220/35/10(20) kV me kapacitet transformues 1x40 MVA.

NS Malisheva do të kyçet në linjën ekzistuese 220 kV NS Drenasi - NS Prizren 2, përmes linjës dyfishe AlÇe 490 $mm^2$ me gjatësi shumë të shkurtë rreth 500m.

**Përfitimet e pritshme nga ky projekt janë:**

- *Furnizimi i besueshëm dhe kualitativ i konsumit të Malishevës;*
- *Optimizimi i rrjedhave të fuqisë dhe shkarkimi i transformatorëve në NS Rahoveci;*
- *Reduktimi i sasive të mëdha të energjisë së padërguar te konsumatori si rrjedhojë e eliminimit të fyteve të ngushta në rrjetin e shpërndarjes;*
- *Reduktimi i humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes;*
- *Përkrahje e zhvillimit ekonomik të Malishevës;*

Eshtë përgaditur specifikimi teknik për projektin bazuar në projekti ”Përgatitja e Dokumentacionit Ndërtimor projektues për NS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën transmetuese 220kV“. Në bazë të planit projekti pritet të tenderohet në vitin 2024 dhe të përfundoj në vitin 2026. Projekti financohet nga buxheti i KOSTT-it.

- **Përgaditja e Dokumentacionit Ndërtimor projektues për Rehabilitimin e NS Vushtrri 1**

Projekti ka si objektiv kryesore përgaditjen e Dokumentacionit Ndërtimor Projektues, për KOSTT (Autoriteti Kontraktues) për dizajnin Konceptual/ideor, Projektin Kryesor, si dhe të gjitha dokumentacionet tjera sipas ligjit, për rehabilitimin e nënstacionit ekzistues Rehabilitimit të NS 110/10(20)kV Vushtrri 1, sipas IEC standardev, Kodit të rrjetit, Kodit të pajisjeve elektrike dhe ligjeve rregullativave dhe ligjit për ndërtim (Ligji për Ndërtim Nr. 04/L – 110, me plotësimet, udhëzimet administrative përkatëse, Ligji i prokurimit, Ligji për Planifikim Hapësinor , etj ) në Kosovë të cilat janë në fuqi.

Kompania kontraktuese do të përgatisë për KOSTT-in ( Autoritetin Kontraktues) komplet Dokumentacionit Ndërtimor Projektues (Projektit Ekzekutiv) për tenderim duke përfshirë të gjitha specifikat teknike dhe ato ndërtimore dhe kërkesat konform Ligjeve në fuqi në Kosovë dhe Standardeve Europiane, për rehabilitimin e instalimin e nënstacionit të ri 110/10920)kV Vushtrri 1 Projekti është tenderuar dhe do të zhvillohet gjate vitit 2024-2025

NS Vushtrri 1 është një ndër nënstacionet e para të ndërtuara në Kosovë me një konfiguracion i cili nuk siguron selektivitet adekuat të mbrojtjeve rele. Ri-vitalizimi i këtij nënstacioni është i domosdoshëm nga fakti që në zbarrat e tij 110 kV janë të lidhura 3 linja 110 kV, njëra prej të cilave bartë fuqinë e gjeneruar nga PE Selaci 105 MW. Gjendja teknike e nënstacionit nuk është e kënaqshme dhe si e tillë rrezikon sigurinë e rrjetit 110 kV që ndërlidhë Vushtrri 2, Trepça, Vallaqi dhe Ilirida. Konfiguracioni aktual i NS Vushtrri 1 nuk siguron selektivitet të duhur në rast të prishjeve në njërën nga linjat e lidhura në nënstacion. Dy linjat 110 kV operojnë vetëm përmes ndërprerësit tërthor. Në përkeqësimin e gjendjes së sigurisë ka ndikuar edhe avaria në NS Trepça e cila aktualisht është e lidhur në rrjetin 110 kV në konfiguracion të pa favorshëm sa i përket sigurisë së rrjetit. Ri-vitalizimi i nënstacionit parasheh ndërrimin e pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV, ndërrimin e sistemit të zbarrave dhe portaleve duke ndërtuar sistemin me zbarra të dyfishta dhe me fushë lidhëse.

Projekti ndërlidhet me projektin: Ri-vitalizimi i segmentit të linjës 110 kV NS Bardhi – NS Ilirida- NS Vallaqi me ç’ rast dy fushat e lira të linjave 110 kV do të shfrytëzohen për këtë projekt si dhe është përkrahje e Energjisë së ripërtrishme.

- **Ndërtimi i baterisë projekt MCA/ KOSTT**

Me nënshkrimin e marrëveshjes në korrik të vitit 2022 në mes të Qeverisë dhe Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) për projektin në vlerë prej 236.7 Milion Dollar. Investimet kryesore të Programit Kompakt përfshin instalimin e Baterive akumuluese me kapacitet 170 MW (340MWh). Sipas marrëveshjes së nënshkruar bateria akumuluese do të jetë dy komponentësh:

- Bateria 45 MW (90MWh) do të shfrytëzohet për nevojat e KOSTT për ofrim të rregullimit sekondar (aFRR) me ç' rast KOSTT do të jetë pronarë i saj dhe të menaxhoj dhe operojnë pajisje për ruajtjen e energjisë; dhe
- Bateria 125 MW(250MWh) do të shfrytëzohet për ofrim të shërbimeve ndihmëse për KOSTT (terciare, startim nga zero) si dhe për arbitrazh të energjisë. Kjo bateri do të jetë në pronësi të një kompanie publike e cila pritet të themelohet.

Pjesëmarrja dhe kontributi i KOSTT-it është si entitet implementues në mes të KOSTT dhe MCA , ku KOSTT është përfitues. KOSTT-i vazhdimisht ka qenë prezent përmesë pjesëmarrjes në grupin punues qeveritar në procesin e zhvillimit të programit të marrëveshjes së financimit më

- Vazhdimësinë e aktiviteteve të ndryshme lidhur me lokacionin për ndërtimin e baterisë së KOSTT-it; dhe
- Themelimin e PIU në kudër të KOSTT për zhvillimin e projektit, në bashkëpunim me MCA.

Projekti është në zhvillim në fazën parapërgaditore, dhe pritet që të përfundoj në vitin 2028;

### 8.2.2. Projektet e planifikuar për vitin 2025

**Shërbimet konsulentë për Projektet e planifikuar nga KfW dhe Grant ( EU/IPA dhe WBIF)**

KOSTT në kuadër bashkëpunimit shumëvjeçar me KfW si njërin nga donatorët dhe financuesit kryesor të zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë, dhe në veçanti KOSTT, dhe bashkëpunimit ndërqeveritar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë, në dhjetor të vitit 2022 ka nënshkruar marrëveshjen për kredi me KfW faza e VII e projekteve si dhe ka aplikuar për Grant në WBIF, si përkrahje për zhvillimin e projekteve të paraparë për fazën e VII.

Konform Marrëveshje me KfW, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kompanisë konsulent për përgaditjen e tender dosjes, por ende nuk janë finalizuar. Të gjitha procedurat janë zhvilluar konform rregullave të KfW .

Projekti i paraparë përmes programit IPA 2024 në EU si grant në vlerë prej 11,5 milion Euro, nuk është zhvilluar për shkak të pezullimit të fondeve si pasoj e situatës politike me Veriun e Kosovës.

Si më poshtë janë dhënë projektet e parapara me këtë paket dhe të cilat planifikohen të fillojnë në vitin 2025 dhe të përfundojnë në vitin 2027-2028.

- Shërbimet Konsulente për projektet;

- Reaktori shant-variabil 100MVAr, 400 kV në NS Ferizaj 2;
- NS Dragashi dhe linja 110 kV NS Kukës-NS Dragash - NS Prizren 2;
- Paketi i projekteteve për SCADA dhe telekom;
- Projektet për Ngritjen e kapaciteteve transformues;
- Revitalizimi i linjave 110 kV; dhe
- Ri-vitalizimi dhe përforcimi i segmentit të linjës 110 kV NS Kosova A-NS Bardhi-NS Ilirida-Vallaq.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar procedurat e prokurimit përmes kfW dhe sipas ligjeve Europiane për projektin " Shërbimet konsulente - faza e VII " të cilët do të jenë të angazhuara për përgaditjen e specifikimeve teknike, procedurave të tenderimit, tenderimin, evaluimin si dhe mbikëqyrjen e projekteve gjate implementimit.

## 9. TABELA E INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2025

**Tabela 1. Investimet Kapitale**

| Kodi buxhetor | Emri i Projektit | Departamenti / Zyrja | Buxheti i planifikuar për projektin ne total | Periudha e Kompletimit | Buxheti i rishikuar 2024 | Buxheti i planifikuar 2025 | Kredi | Kostt | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/26 | Shpronësimi dhe servituti për projektet e Berzh, programi IPA dhe të tjera | Z L | **1,000,000** | TM2 2017 - TM4 2027 | 400,000 | 1,000,000 | | 1,000,000 | | |
| 023/115 | Shërbimet konsulente faza VII - KFW | Zhv. Rrj | **2,500,000** | TM1 2023- TM4 2027 | 300,000 | 600,000 | 300,000 | 300,000 | 600,000 | 700,000 |
| 023/140 | Ndërtimi i Nënstacionit të ri - GIS 110/35/10(20)kV Kastrioti (Ferizaj) me një transformatore të fuqisë 40MVA (LOT1) | Zhv. Rrj | **4,956,000** | TM2 2021- TM2 2025 | 24,000 | 17,000 | | 17,000 | | |
| 023/140-1 | Linja transmetuese 110kV për NS Ferizaj 3 ( Kastriot) | Zhv. Rrj | **1,534,000** | TM2 2021- TM2 2025 | 591,601 | 184,942 | | 184,942 | | |
| 023/155 | Ndërtimi i Nënstacionit të ri - GIS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova (LOT2) | Zhv. Rrj | **4,250,000** | TM4 2021 - TM4 2025 | 771,819 | 161,784 | | 161,784 | | |
| 023/157 | Transformatori i fuqisë 40MVA në NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova | Zhv. Rrj | **1,156,400** | TM1 2023 - TM4 2025 | 809,480 | 115,640 | | 115,640 | | |
| 023/156 | NS 220/35/10(20) kV - Malisheva linjat transmetuese 220kV dhe transformator 1x40MVA | Zhv. Rrj | **6,836,500** | TM2 2024 - TM2 2027 | 1,025,475 | 1,367,300 | | 1,367,300 | 2,050,950 | 683,650 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/158 | *NS 220/35/10(20) kV - Malisheva linjat transmetuese 220kV dhe transformator 1x40MVA*<br>*Furnizimi dhe instalimi I Reaktori shant-variabil 100 MVAr, 400 kV në NS Ferizaj 2* | Zhv. Rrj | **236,000** | TM1 2023-TM1 2024 | 94,000 | | | | | |
| | *Ri-vitalizimi i pajisjeve të TL 110kV në NS Vushtrri 1* | Zhv. Rrj | **159,000** | TM2 2023-TM2 2025 | 159,000 | 135,150 | | 135,150 | | |
| 023/126 | Furnizimi me pjesë rezervë për Nënstacione | OT | **1,815,000** | TM1 2023 - TM4 2027 | 500,000 | 622,000 | | 622,000 | 326,271 | 326,271 |
| 023/125 | Furnizim me pjesë rezervë për mirëmbajtje të linjave transmetuese | OT | **1,835,000** | TM1 2023 - TM4 2027 | 460,000 | 656,000 | | 656,000 | 385,000 | 385,000 |
| 023/100 | Furnizimi me Instrumente dhe Vegla speciale për kabllo tëtensionit të lartë | OT | **118,000** | TM4 2024 - TM4 2025 | 118,000 | 118,000 | | 118,000 | | |
| 023/101 | Furnizimi me dron (DronI, Software, Trajnimi, Analiza e të dhenave) | OT | 95,000 | TM4 2024 - TM4 2025 | 95,000 | 95,000 | | 95,000 | | |
| 023/102 | Furnizimi me paisje speciale për ekipin e mirëmbajtjes | OT | 100,000 | TM4 2024-TM4 2025 | 50,000 | 100,000 | | 100,000 | | |
| 023/12 | Furnizimi me kthina 20kV | OT | 550,000 | TM4 2024-TM4 2025 | 550,000 | 550,000 | | 550,000 | | |
| 023/14 | Furnizimi dhe montimi i shenjave për sinjalizim të linjave sipas kerkesës së Aviacionit Civil | OT | 550,000 | TM1 2023 - TM4 2027 | 137,500 | 250,000 | | 250,000 | 137,500 | 137,500 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/15 | Furnizim me pajisjen testuese për mbrojtje rele Omikron CMC | OT | 150,000 | TM4 2023 - TM4 2024 | 150,000 | | | | | |
| 023/27 | Furnizimi dhe montimi i ridrejtuesve modular 110VDC&220VDC, Invertor modular, konverter 110/48VDC 220/48VDC dhe shpërndarje DC | OT | 255,000 | TM1 2023- TM4 2027 | 68,000 | 76,700 | | 76,700 | 38,000 | 32,000 |
| 023/13 | Softueri për kalkulimin e parametrave dhe selektivitetit të Mbrojtjeve rele | OT | **25,000** | TM4 2023- TM4 2024 | 25,000 | | | | | |
| 023/28 | Furnzimi dhe instalimi i baterive industriale pa mirëmbajtje | OT | **220,000** | TM1 2023- TM4 2027 | 43,000 | 88,500 | | 88,500 | 38,000 | 29,000 |
| 023/17 | Furnizimi me Pajisje Testuese për Testimin e Transformatoreve Energjetik | OT | **180,000** | TM1 2025- TM4 2025 | | 180,000 | | 180,000 | | |
| 023/19 | Furnizim me pajisje speciale për ekipin e mirëmbajtjes së linjave | OT | **120,000** | Q3 2024- Q4 2025 | 120,000 | 120,000 | | 120,000 | | |
| 023/70 | Ndërrimi i mbrojtjeve rele të linjave ajrore dhe TR1&TR2 në NS Prizreni 1 110/35/10kV | OT | **330,000** | TM1 2025- TM4 2025 | | 330,000 | | 330,000 | | |
| 023/71 | Furnizimi dhe montimi i tabelave për shenimin e shtyllave dhe linjave | OT | **70,800** | TM1 2025- TM4 2025 | | 70,800 | | 70,800 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/72 | Vendosja e shkarkueseve në disa linja për evitimin e shkarkimeve të mbitensioneve atmosferike | OT | **120,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 120,000 | | 120,000 | | |
| 023/16 | Furnizimi me makineri për tërheqjen e përquesve | OT | **354,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 354,000 | | 354,000 | | |
| 023/10 | Përmirësimi i Izolimit të Anës 220 kV në NS Kosova A | OT | **377,600** | TM1 2025-TM4 2025 | | 377,600 | | 377,600 | | |
| 023/73 | Rikonfigurimi i trasesë së linjës “NS Trepçë-NS Vallaç” | OT | **90,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 90,000 | | 90,000 | | |
| 023/147 | Rregullimi i Dhomës Rezervë të Servereve, Qendra Emergjente | Sh P | **330,000** | TM4 2022 - TM4 2024 | 330,000 | | | - | | |
| 023/153 | Punimi i depos së mbyllur në Obiliq | Sh P | **168,740** | TM1 2025-TM4 2025 | 168,740 | 167,750 | | 167,750 | | |
| 023/151 | Renovimi i ndërtesave Komanduese në: NS Prizreni 2; NS Vitia; NS Gjakova 1(kati perdhese), Prishtina 4 dhe NS tjera sipas nevojës | Sh P | **143,000** | TM4 2023 - TM4 2027 | 77,000 | 143,000 | | 143,000 | 22,000 | 22,000 |
| 023/152 | Renovimi i rrethojave në: NS Burimi dhe NS Prishtina 5 dhe NS Vitia | Sh P | **143,000** | TM1 2023 - TM4 2027 | 88,000 | 88,000 | | 88,000 | | |
| 023/18 | Punimi i kyçjeve në rrjet të qytetit të ujit dhe kanalizimit dhe punimi i rrugeve të qasjes në: NS Gjilani 5, NS Vushtrria 2 dhe NS tjera sipas pëlqimeve nga Komuna | Sh P | **55,000** | TM1 2022 - TM4 2027 | 11,000 | 11,000 | | 11,000 | 11,000 | 11,000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/167 | Renovim i pjesës së lokaleve në Kurriz-mbi plato | Sh P | **49,500** | TM1 2025-TM4 2025 | 49,500 | 100,000 | | 100,000 | | |
| 023/141 | Ndërtimi i infrastrukturës së Sigurisë së Lartë në Selinë Qendrore | Sh P | **220,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 220,000 | 220,000 | | 220,000 | | |
| 023/21 | Softuer për detektimin e sulmeve kibernetike | Sh P | **77,000** | TM1 2025 -TM4 2026 | 38,500 | 39,000 | | 39,000 | 38,500 | |
| 023/11 | Licensa për Antivirus | Sh P | **88,000** | TM1 2023 -TM4 2027 | 35,200 | 26,200 | | 26,200 | 16,500 | 27,300 |
| 023/30 | Ndërrimi i pajisjeve të rrjetës LAN në qendër dhe Nënstacione | Sh P | **330,000** | TM4 2023-TM4 2025 | 165,000 | 165,000 | | 165,000 | | |
| 023/31 | Licensa për softuer (MS Project, MS Visio, SQL Server, Acrobat, Netwriks Auditing, Remote Aministratione, Solar winds patch Menager dhe te tjera) | Sh P | **220,000** | TM4 2023-TM4 2025 | 110,000 | 110,000 | | 110,000 | | |
| 023/32 | Zhvillimi dhe avansimi i Kosttportalit sipas kërkesave të reja | Sh P | **55,000** | TM4 2023-TM4 2025 | 55,000 | 55,000 | | 55,000 | | |
| 023/33 | Furnizimi me Harduer | Sh P | **880,000** | TM1 2023-TM4 2026 | 430,000 | 220,000 | | 220,000 | 220,000 | |
| 023/34 | Sistemi i Backupit | Sh P | **385,000** | TM4 2024-TM4 2025 | 385,000 | 385,000 | | 385,000 | | |
| 023/35 | Licensat NGFW | Sh P | **144,000** | TM1 2023-TM4 2027 | - | 100,000 | | 100,000 | | 44,000 |
| 023/36 | Licensa Barrakuda | Sh P | **33,000** | TM1 2023-TM4 2027 | - | 11,000 | | 11,000 | | 16,500 |
| 023/37 | Furnizimi me inventarë | Sh P | **55,000** | TM1 2023-TM4 2027 | 11,000 | 11,000 | | 11,000 | 11,000 | 11,000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/104 | Punimi i infrastruktures përcjellese në lokacionin e NS Kosova B | Sh P | **66,000** | TM1 2024-TM4 2025 | 66,000 | 55,000 | | 55,000 | | |
| 023/105 | Renovimi i objektit afarist në Obiliq Kastriot | Sh P | **365,500** | TM4 2024-TM4 2025 | 365,500 | 300,000 | | 300,000 | | |
| 023/106 | Furnizim me OPGW dhe elementet përcjellëse për mirëmbajtjen e rrjetit fibër optike | Sh P | **80,000** | TM4 2024-TM4 2025 | 80,000 | 80,000 | | 80,000 | | |
| 023/107 | Electronic Highway - ENTSO-E | Sh P | **150,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 150,000 | 150,000 | | 150,000 | | |
| 023/39 | Avancimi i Aplikacionit të Aseteve | Sh P | **125,000** | TM1 2024-TM4 2026 | 41,667 | 125,000 | | 125,000 | 41,667 | |
| 023/50 | Renovimi i objektit te KOSTT në lokacionin e SSH Drenas | Sh P | **231,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 231,000 | | 231,000 | | |
| 023/29 | Furnizim me rafta industrial | Sh P | **10,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 10,000 | | 10,000 | | |
| 023/24 | Furnizim me Automjet me Platëform Punuese-Korpë | Sh P | **85,000** | TM1 2025-TM4 2025 | | 85,000 | | 85,000 | | |
| 023/103 | Furnizim me kamionetë | Sh P | **100,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 82,600 | 100,000 | | 100,000 | | |
| 023/22 | Integrimi në Platformen e ENTSO-E- VP Platform (RG CE function) | OS | **350,000** | TM1 2023 - TM4 2027 | 155,000 | 155,000 | | 155,000 | 50,000 | 50,000 |
| 023/108 | Rehabilitimi i Marshalling Kiosk për Transformatoret e Kombinuar 110kV në NS distributive 110/x kV | OS | **55,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 55,000 | 55,000 | | 55,000 | | |
| 023/109 | Module shtesë të softwerit NEPLAN - Short Circuit dhe eksporti në formatin *raw file | OS | **17,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 17,000 | 17,000 | | 17,000 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 023/40 | Furnizimi me pajijse MDC (10 cope) për kompletimin e nënstacioneve distributive 110/x kV | OS | **55,000** | TM4 2023-TM4 2024 | 50,000 | | | | | |
| 023/41 | Ndërtimi i infrastrukturës së Arkivës së përgjithshme KOSTT dhe Arkivës së Menaxhimit të Projekteve | BNJ | **220,000** | TM1 2025-TM4 2025 | 220,000 | 215,500 | | 215,500 | | |
| 023/54 | Kostoja e rritjes së kapitalit për tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri (ALPEX) | | **863,200** | TM1 2025-TM1 2026 | | 431,600 | | 431,600 | 431,600 | |
| **Totali** | | | | | **11,242,145** | **11,642,466** | **300,000** | **11,342,466** | **4,417,988** | **2,475,221** |

## 10. PLANIFIKIMI FINANCIAR

Bordi i Zyres së Rregullatorit për Energji (ZRrE), me datë 23 mars 2023 nxori Vendim, Aprovohen të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT Sh.A), për periudhën e tretë Rregullative PRR3 (2023-2027).

Të hyrat e planifikuara të KOSTT-it për vitin 2025 janë kalkuluar bazuar në të hyrat indicative pesëvjeqare të lejuara nga ZRrE, të përcaktuara me shqyrtimin tarifor për periudhën e dytë tarifore 2023-2027.

Të hyrat për mbulimin e Shërbimeve Ndihmëse të lejuara nga ZRrE janë përshtatur me ecurin e realizimit të vitit 2024, të cilat duhet të korrigjohen me rastin e aprovimit të të hyrave për vitin 2025.

Pas aprovimit të tarifave për vitin 2025 nga ana e ZRrE-së, ky Buxhet do të rishikohet.

Buxheti është hartuar në harmoni me Ligjin për Buxhetin si dhe me ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

Sipas Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike për vitin 2025, prodhimi i energjisë elektrike i cili hyn në rrjetin e transmetimit e prodhuar nga TC Kosova A, TC Kosova B, HC Ujmani HC-Kaskada e Lumbardhit, Parku i erës Kitka dhe Sowi Kosova (Selaci) **për vitin 2025**, **është planifikuar të jetë 5,154.3 GWh.**

Ndërsa, **prodhimi i përgjithshëm nacional**, duke përfshirë edhe HC-të të kyçura në Shpërndarje dhe gjeneratorët me erë dhe me panele diellore, planifikohet të jetë **5,367.8 GWh.**

Të hyrat nga tarifat direkte të planifikuara për vitin kalendarik **2025 janë 59,037,149 €.** Të hyrat për burimet e ripërtëritshme janë planifikuar **58,433,359** €, së bashku me përshtatjen e të hyrave për Shërbimet Ndihmëse, të hyrat totale për vitin 2025, përfshirë edhe të hyrat e planifikuara për burimet e ripërtëritshme për vitin kalenderik **117,470,508 €.**

Përveç të hyrave nga tarifa dhe Burimet e Ripëretritshme, KOSTT ka planifikuar edhe të hyrat tjera në vlerë prej **14,600,000** €, që së bashku arrijnë vlerën prej **132,070,508 €.**

## 10.1. Struktura dhe vlera e të hyrave për vitin 2025

**Tabela 2. Të hyrat**

Shënimet janë në 000 Euro

| | | Buxheti i rishikuar | Buxheti i planifikuar |
|---|---|---|---|
| | | **2024** | **2025** |
| N.r | **TË HYRAT** | | |
| 1 | Të hyrat nga operatori i transmisionit 220 /400 kV | 322 | 289 |
| 2 | Të hyrat nga operatori i transmisionit 110 kV | 19,779 | 17,706 |
| 3 | Të hyrat nga operatori i sistemit | 34,354 | 30,754 |
| 4 | Të hyrat për përshtatjen e shërbimeve ndihmëse | - | 10,000 |
| 5 | Të hyrat nga operatori i tregut | 322 | 288 |
| 6 | Të hyrat për Burimet e Ripërtëritshme nga fondi dhe tarifa | 60,803 | 58,433 |
| 7 | **Të hyrat nga tarifat (1 deri 6)** | **115,580** | **117,471** |
| 8 | Të hyrat tjera operative | 380 | 380 |
| 9 | Te hyrat nga alokimi i kapaciteteve interkonektive | 9,800 | 7,800 |
| 10 | Të hyrat nga tranziti | 600 | 420 |
| 11 | Të hyrat e shtyera | 6,500 | 6,000 |
| 12 | **Gjitësejt të hyrat tjera (8 deri 11)** | **17,280** | **14,600** |
| 13 | **GHITHËSEJT TË HYRAT (7+12)** | **132,860** | **132,071** |

## 10.2. Shpenzimet operative

Të hyrat e lejuara do të shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve operative dhe kostove të kapitalit. Kategoritë kryesore të shpenzimeve operative janë:

**Shpenzimet e blerjes së energjisë - Humbjet në Transmetim**

Shpenzimet e blerjes së energjisë për humbjet në transmetim janë planifikuar në vlerën **10,000,000 €.**

**Shpenzimet e planifikuara të stafit për vitin 2025, janë 6,653,821 €**.

**Pagat për Bordin e Drejtorëve, janë 106,596 €.**

**Mirëmbajtja -** Shpenzimet për mirëmbajtje në buxhetin e vitit 2025 janë planifikuar në vlerën prej vlerën **966,275 €.**

**Shpenzimet tjera operative**

Kjo kategori e shpenzimeve përfshinë shpenzimet e përgjithshme, të domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve të KOSTT-it, në këtë buxhet janë planifikuar në vlerën **2,315,500 €.**

Shpenzimet e interesit për huamarrje janë planifikuar **1,500,000 €.**

Shpenzimet e tranzitit janë planifikuar **420,000 €.**

Shpenzime përmbarimore janë planifikuar **100,000 €.**

Shpenzime për konteste gjyqesore dhe të tjera janë planifikuar 1**50,000 €.**

Vendimi i ZRrE-s për penalitete **439,405 €**

Shpenzime vjetore të parashikuara në kuadër të Marrëveshtjes së Kyçjes KOSTT-CESA për pagesa kundrejt ENTSO-E **150,000 €**

Shërbimet për RSC **250,000 €**

**Shpenzimet e shërbimeve ndihmëse** të planifikuara janë në vlerën prej **28,600,000 €.**

## 10.3. Planifikimi i Pasqyrës së të Ardhurës ( Fitimit/Humbjes) për vitin 2025

**Tabela 3. Pasqyra e të Ardhurave**

*në 000 Euro*

| | | Buxheti i rishikuar | Buxheti I planifikuar |
|---|---|---|---|
| | | **2024** | **2025** |
| N.r | **TË HYRAT** | | |
| 1 | Të hyrat nga operatori i transmisionit 220 /400 kV | 322 | 289 |
| 2 | Të hyrat nga operatori i transmisionit 110 kV | 19,779 | 17,706 |
| 3 | Të hyrat nga operatori i sistemit | 34,354 | 30,754 |
| 4 | Të hyrat për përshtatjen e shërbimeve ndihmëse | | 10,000 |
| 5 | Të hyrat nga operatori i tregut | 322 | 288 |
| 6 | Të hyrat për Burimet e Ripërtëritshme nga fondi dhe tarifa | 60,803 | 58,433 |
| 7 | **Të hyrat nga tarifat (1 deri 6)** | **115,580** | **117,471** |
| 8 | Të hyrat tjera operative | 380 | 380 |
| 9 | Te hyrat nga alokimi i kapaciteteve interkonektive | 9,800 | 7,800 |
| 10 | Të hyrat nga tranziti | 600 | 420 |
| 11 | Të hyrat e shtyera | 6,500 | 6,000 |
| 12 | **Gjitësejt të hyrat tjera (8 deri 11)** | **17,280** | **14,600** |
| 13 | **GHITHËSEJT TË HYRAT (7+12)** | **132,860** | **132,071** |
| 14 | **Shpenzimet operative (15 deri 28)** | **100,809** | **108,685** |
| 15 | Mirëmbajtja | 1,124 | 966 |
| 16 | Shpenzimet e stafit | 6,371 | 6,654 |
| 17 | Pagat për Bordin e Drejtorëve | 107 | 107 |
| 18 | Shpenzimet tjera operative | 2,114 | 2,316 |
| 19 | Shërbimet ndihmëse | 23,000 | 28,600 |
| 20 | Humbjet në transmetim | 9,000 | 10,000 |
| 21 | Shpenzimet e tranzitit | 600 | 420 |
| 22 | Shpenzimet e interesit për huamarrje | 1,500 | 1,500 |
| 23 | Shpenzimet për Burimet e Ripertriteshme nga tarifa dhe fondi | 56,603 | 57,033 |
| 24 | Shpenzime vjetore të parashikuara në kuadër të Marrëveshtjes së Kyçjes KOSTT-CESA për pagesa kundrejt ENTSO-E. | 100 | 150 |
| 25 | Sherbimi për RSC | 100 | 250 |
| 26 | Shpenzime përmbarimore | 140 | 100 |
| 27 | Shpenzime për konteste gjyqësore dhe të tjera | 50 | 150 |
| 28 | Vendimi i ZRrE-s për penalitete | | 439 |
| 29 | **Fitimi para amortizimit (13 - 14)** | **32,051** | **23,386** |
| 30 | Zhvleresimi/Amortizimi | 15,200 | 15,000 |
| 31 | **Gjithësejt shpenzimet operative (14 + 30)** | **116,009** | **123,685** |
| 32 | **Fitimi / Humbja para tatimit (13 - 31)** | **16,851** | **8,386** |
| 33 | Shpenzimet e tatimit në fitim | | |
| 34 | **Neto fitimi / Humbja ( 32 - 33)** | **16,851** | **8,386** |

## 10.4. Parashikimi i rrjedhës së parasë së gatshme 2025

**Tabela 4. Rrjedha e Parasë**

**000 euro**

| | **2025** |
|---|---|
| **1. Flukset operacionele të parasë së gatshme** | **5,743** |
| Pranimet nga blerësit | 126,071 |
| Pagesat e furnitorëve | (113,567) |
| Pagesat ndaj punëtorëve | (6,760) |
| | |
| **2. Flukset investive të parasë së gatshme** | - |
| Interesi i arkëtuar | - |
| | |
| **3. Flukset financiare të parasë së gatshme** | **(6,476)** |
| Marrja e kredisë | 300 |
| Kthimi i kredise Qeverisë | |
| Ripagimi i kredive | (5,276) |
| Pagesa e interesit për kredi | (1,500) |
| Grantet e pranuara | - |
| **4. Rrjedha e parasë së gatshme për periudhën (1+2+3)** | **(733)** |
| **5. Balanca fillestare** | **34,280** |
| **6. Balanca perfundimtare (4+5)** | **33,547** |

***Note; Pasqyra është pa efektet e llogarisë balancuese***

## 11. QËNDRUESHMËRIA AFARISTE

### 11.1. Personeli

Nga viti 2023 ZRrE me aprovimin e buxhetit nuk kufizon edhe numrin maksimal të punëtorëve, kështu që duke u bazuar në numrin aktual të pozitave të aprovuara në SVP (Sistematizimin e vendeve të punës), gjatë vitit 2025, është planifikuar të jetë 395 punëtorë.

Ky numër i punëtorëve është i projektuar dhe bazuar në objektivat strategjike dhe në ngritjen e kapaciteteve operative të KOSTT-it. KOSTT-i është duke implementuar shumë projekte dhe me përfundimin e tyre, paraqitet nevoja e operimit me këto kapacitete të reja. Gjithashtu, kërkesat për punëtorë ndërlidhen edhe me rritjen e obligimeve në raport me ENTSO-E, rritja e numrit të aseteve, numrin e NS-ve të cilat operohen nga KOSTT-i, duke i marrë parasysh edhe kërkesat për një numër më të madh të punëtorëve për mirëmbajtjen e NS 110 kV si dhe nevojat të ndërlidhura me zhvillimet tjera të KOSTT-it. Sipas kërkesës për rritjen e numrit të punëtorëve për ZRrE gjatë shqyrtimeve tarifore, nga periudha tarifore 2023 – 2027, ZRrE nuk kufizon numrin e lejuar të punëtorëve, kështu që mbetët që KOSTT-i të vlerësojë, në mes të nevojave për rritje të stafit dhe mundësive buxhetore të aprovuar nga ZRrE për periudhën tarifore 2023-2027.

Zhvillimi i BNJ në KOSTT në përgjithësi është i orientuar në harmoni me strategjinë e kompanisë. Duke marrë parasysh këtë, KOSTT ka krijuar politikat dhe procedurat për të siguruar se stafi mund të kontribuojë sa më efektshëm, për të arritur objektivat e vendosura. Këto politika mbulojnë planifikimin e BNJ, rekrutimin dhe selektimin, trajnimin dhe zhvillimin e aftësive, menaxhimin e performancës, menaxhimin e shpërblimit dhe barazinë gjinore, zhvillimin e karrierës dhe menaxhimin e talentëve, krijimin e një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm për punë dhe përfshirjen e komuniteteve tjera, si dhe politikat tjera të Teknologjisë së Informacionit por edhe të menaxhimit të objekteve. Duke i marrë parasysh ndryshimet në legjislacionet përkatëse, por edhe ndryshimet e brendshme si dhe nevojat strategjike të KOSTT-it, këto politika të aprovuara rishikohen permanent. Gjithashtu krahas rishikimit të politikave bëhet edhe rishikimi i procedurave dhe dokumenteve tjera relevante në harmoni me këto kërkesa.

Për zhvillim më efikas të menaxhimit të BNJ dhe shfrytëzimit të teknologjive më të reja të TI gjatë vitit 2019 është bërë kalimi nga modulet e vjetra CAS_HR dhe CAS_Paga në aplikacionin e ri HeRa, i cili ka sistemin për menaxhimin e BNJ dhe sistemin e pagave dhe është i ndërlidhur edhe me modulin për Menaxhimin personal të të dhënave, ku secili punëtorë ka qasje në një pjesë të të dhënave personale dhe mund të inicoi kërkesat për pushime, sipas nevojës.

KOSTT-i ka implementuar edhe aplikacionin për menaxhimin elektronik të dosjeve të punëtorëve, i cili ka mundësuar punë më të lehtë me dosjet e personelit në mënyrë të organizuar sipas standardeve dhe politikave të vendosura me mundësitë e integrimit edhe me sistemin e burimeve njerëzore, duke i mundësuar personelit qasjen e tyre në dosjet e tyre personale. Ky aplikacion dhe aplikacionet tjera do të zhvillohen në të ardhmen varësisht prej nevojave, kërkesave dhe zhvillimeve të reja.

Në vitin 2025 parashihet zhvillimi i një aplikacioni të ri Aplikimi online për punësim, me të cilin do të mundësohet krijimi i një sistemi duke u integruar edhe me sistemin e burimeve njerëzore. Ky modul do të

lehtësonte procesin e rekrutimeve, punë më të lehtë me menaxhimin e aplikacioneve dhe dosjet e aplikimeve online duke u respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Me këtë aplikacion do të krijohet një sistem i cili do të mundësoj menaxhimin e procesit të rekrutimit në tërësi, me ç'rast do të kursehej dukshëm koha e cila shpenzohet për menaxhim të këtij procesi sipas dispozitave dhe afateve ligjore.

## 11.2. Implementimi dhe matja e performancës

Implementimi i Planit të Biznesit do të përfshij tri (3) elemente kryesore:

- Vendosja e objektivave dhe identifikimi i veprimeve për çdo departament funksional. Secili departament ka përgatitur një plan operativ bazuar në objektivat e Planit të Biznesit pesëvjeçar dhe planet e veçanta vjetore si ekstrakte dhe vendosjen e objektivave për departamentin dhe veprimet e nevojshme për t'i arritur ato. Vendosja e objektivave do të përcillet për çdo vit pasues;
- Vendosja e buxhetit vjetor për KOSTT-in dhe për çdo departament. Plani i Biznesit do të vendos kontekstin strategjik për buxhetin dhe themelon një bazë për të shfrytëzuar burimet financiare dhe fuqinë punëtore; dhe
- Monitorimi i performancës ndaj objektivave dhe buxhetit. Monitorimi i rregullt i performancës në raport me planin, buxhetin, kohën e realizimit dhe qëllimet e vendosura përmes një sistemi të menaxhimit të performancës, është një çështje esenciale. Ky monitorim do të zbatohet përmes raportimit të rregullt të menaxhmentit.

Sistemi për menaxhimin e performancës do të bazohet në treguesit e vendosur për objektivat strategjike. Procesi i vlerësimit do të kryhet për periudhë vjetore (1 herë në vit).

Procesi i menaxhimit të performancës shtrihet edhe lartë – poshtë duke përfshirë edhe stafin, por gjithashtu ky proces i menaxhimit të performancës do të zhvillohet dhe përmirësohet më tutje në harmoni me zhvillimet dhe kërkesat e reja

## 11.3. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Në bazë të analizës së nevojave për trajnime, do të hartohet një plan i trajnimeve i cili do të merret në konsiderim gjatë implementimit të trajnimeve. Trajnimet do të fokusohen konform nevojave dhe do të mbulojnë të gjitha trajnimet e nevojshme për një ngritje profesionale, efeçiente dhe të sigurt në punë.

Shkathtësitë dhe zhvillimi i stafit është një nga prioritetet e KOSTT-it si synim për realizimin e objektiva dhe arritjen e caqeve të përcaktuar brenda Planit të Biznesit. Në kuadër të kësaj, KOSTT-i do të promovojë politikat për zhvillimin e talenteve të rinjë, duke rishqyrtuar politikat e rekrutimit, bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë dhe institucione tjera relevante.

Programet zhvillimore, kurset dhe trajnimet specifike, trajnimi fillestar, zhvillimi i shkathtësive menaxhuese, do të jenë preokupim i BNJ edhe për këtë fazë, për të siguruar që personeli të fitoje shkathtësitë e nevojshme për t'i përcjellë zhvillimet në KOSTT. Edhe më tutje, do të vazhdohet dhe do të implementohen projekte për praktikë profesionale, gjegjësisht Internshipi për studentë në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës – Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, Universitetin per Biznes dhe Teknologji (UBT) – drejtimin Inxhinieria e Energjisë, Kosovo CSR Network, MCC dhe projektet tjera.

KOSTT-i gjatë viti akademik 2024/2025, në përkrahje të zhvillimit të kuadrove dhe talenteve në sektonin e energjisë elektrike, planifikon ndarjen e disa bursave për studentë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në përputhje me Politiken për ndarje të Bursave .

Mungesa e stafit profesional për mirëmbajtjen për asetet e teknologjive të reja (Linjat dyfishe, kabllot e tensionit të lartë, sistemet konvertorike etj.), do të zë pozicion më të rëndësishëm në planin e trajnimeve dhe përkushtim të veqantë në realizimin e trajnimeve dhe aftësimin e stafit.

Në Plan të trajnimeve, do t'i kushtohet kujdes trajnimeve për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje të mjedisit, në përputhje me kërkesat e standardeve ISO 14001 dhe 45001. Në përgjithësi, do t'i kushtohet kujdes ngritjes së kapaciteteve të stafit në fushën e standardeve; (9001; 14001; 45001; 5001; 27001) përfshirë edhe certifikimin e stafit, sipas kërkesave të standardeve. Bazuar në Sistemin e Integruar të menaxhimit dhe kërkesat e standardeve në implementim dhe standardeve të cilat janë duke u zhvilluar në KOSTT, do të hartohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në fushën e standardeve.

### 11.4. Menaxhimi i cilësisë

KOSTT qysh nga viti 2009 ka qenë i certifikuar me fillimisht me Standardin ISO 9001:2008, ndërkaq në vitin 2017 është i certifikuar me Standardin ISO 9001:2015 i cili është i bazuar në principet e menaxhimit kualitativ dhe përmban kërkesa të reja me fokus të posaçëm në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë me përfshirjen e Menaxhmentit të lartë për të arritur një menaxhim efektiv në kompani. Në të njëjtën kohë KOSTT është certifikuar edhe me standardin ISO 14001 dhe ISO 45001, ndërkaq në dhjetor të vitit 2021 KOSTT është certifikuar edhe me standardin ISO 27001.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave të standardit për menaxhimin kualitativ në vitin 2023, KOSTT e ka përfunduar auditimin e jashtëm mbikëqyrës verifikues me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015,ISO 45001:2018 nga kompania ndërkombëtare certifikuese RoyalCert e cila ka bërë raportin e auditimit pa asnjë jo-konformitet si dhe auditimin mbikëqyrës verifikues për standardin ISO 27001:2013 nga kompania G-Certi edhe kjo pa asnjë jo-konformitet Para auditimit të jashtëm është zhvilluar auditimi i brendshëm nga ekipi i brendshëm për cilësi i cili është i trajnuar dhe certifikuar për auditimin e brendshëm.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë KOSTT, KOSTT ka ndërtuar një "Sistemi të integruar të Menaxhimit të Cilësisë" dhe kështu ka krijuar mundësinë e integrimit edhe të standardeve tjera të cilat mund të zhvillohen në të ardhmen.

Në vitin 2024/2025 do të bëhet Auditimi ri-certifikues për Standardet ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001: 2018 dhe ISO 27001:2013, ndërkaq në vitin 2025 bëhet auditimi mbikëqyrës verifikues për të gjitha këto standarde ISO

Do të ketë përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë duke i përcjellë zhvillimet e reja në sektorin e energjisë respektivisht, procesin e integrimeve evropiane, dhe në harmoni me këto zhvillime KOSTT duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të kërkesave dhe standardeve te reja që rrjedhin nga këto procese, dhe për këtë qëllim në vitin 2025 është planifikuar të bëhen përgatitjet për certifikim edhe me ndonjë standard ndërkombëtar i ndërlidhur me biznesin e KOSTT. Për këtë qëllim duhet të angazhohet një konsulence e cila do ta përgatitë kompaninë për certifikim me një standard i cili do të aprovohet nga Menaxhmenti

Plotësimi i standardeve gjithashtu është kërkesë e procesit të zhvillimit të projekteve voluminoze në KOSTT.

### 11.5. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit(TIK)

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit duke shfrytëzuar të arriturat e zhvillimit të saj dinamike ofron përkrahjen në realizimin e proceseve afariste të kompanisë me qëllim të arritjes sa më efikas të detyrave, më lehtë, më shpejt, më saktë dhe më sigurtë. TIK përveç kësaj ofron edhe promovimin e kompanisë, infrastrukturën komunikuese të telefonisë fikse dhe sistemin e vëzhgimin (CCTV).

Në KOSTT sektori TIK i realizon obligimet e tij në realizimin e proceseve afariste në Departamentin e Financa, Kontabilitetit dhe Thesarit, Burime Njerëzore, Menaxhim dhe Implementimi i Projekteve, Prokurim, Çështjet Rregullative dhe Tarifat, Auditim, Komunikimin me palët e jashtme, arkivimi digjital të dokumentacionit si dhe ndërlidh funksione të Operatorit të sistemit, Operatorit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut në drejtim të realizimit të vizionit të KOSTT. Përmes infrastrukturës së TIK këto procese duhet të realizohen në mënyrë të sigurt dhe të besueshme prandaj kjo infrastrukturë duhet të mirëmbahet dhe të zhvillohet vazhdimisht konform nevojave dhe trendit zhvillues kështu gjatë pesëvjeçarit 2023-2025 si imperativ përveç mirëmbajtës së gjendjes ekzistuese janë :

- Krijimi i qendrës emergjente të të dhënave për sistemin TIK;
- Përtërija e harduerit në qendrën e të dhënave në Selinë Qendrore për shkak se një pjesë e tij është vjetruar (storage, server, firewall);
- Përmirësimi i sistemit CCTV në nënstacione;
- Përtërija e rrjetit në Nënstacione me switcha të rinj;
- Krijimi i redudancës së plotë të sistemit të TIK në qendrën e të dhënave;
- Zhvillimet e reja në drejtim të digjitalizimit të një numri të proceseve në Menaxhimin e Projekteve, Buxhet, Burime Njerëzorë, Financa dhe Shërbime Përkrahëse;
- Përforcimi i sigurisë kibernetike me implementimin e politikave të TIK dhe praktikave/rregullativave të mirënjohura;

- Zbatimi e rekomandimeve që dalin nga testet e Penetrimit i cili është paraparë çdo vit në funksion të mbrojtjes nga sulmet kibernetike (rekomandime të ndryshme lidhur me ndryshime në harduer dhe softuer);
- Realizimin e përgjegjësive që dalin nga Ligji i Sigurisë Kibernetike, Agjencionit të Sigurisë Kibernetike dhe CERTit sektorial të energjisë (dy të fundit janë ende në fazat e themelimit);
- Blerja e softuerit të nevojshëm, atij monitorues, certifikatave si dhe përtërija e licencave të softuerit dhe harduerit; dhe
- Implementimi i mëtutjeshëm i klauzolave të ISO 27001 që i takojnë TIK.

### 11.6. Menaxhimi i ndërtesave

Në kuadër të Menaxhimit të ndërtesave do të vazhdohet me renovimin e ndërtesave komanduese në NS, me qasje të posaçme të Ndërtesa komanduese e NS Prizreni 2 dhe NS Prishtina 4, duke bërë përmirësimin e kushteve të punës, krijimin e ambienteve për punë si dhe efiçencës së energjisë në këto objekte, por duke mos lënë anash edhe mirëmbajtjen vijuese të tyre.

Në kuadër të këtyre projekteve prioritet i është dhënë ndërrimit të dritareve dhe dyerve metalike me qelq të njëfishtë duke i zëvendësuar me termike, mbështjellja e fasadave me material termoizolues, furnizimin permanent me ujë të pijshëm për punëtorë dhe ujë për nevoja sanitare si dhe gjelbërimin e NS në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare.

Në vitin 2024/2025 nga aspekti i mbrojtjes fizike të objekteve është planifikuar ndërtimi i rrethojës në NS 110Kv Itogu/Burimi, NS Prishtina 5 dhe NS 110Kv Vitia sipas standardeve paraprakisht të aprovuara për rrethoja, në varësi nga vlerat e aprovuara buxhetore.

Në vitin 2019 ka hy në fuqi LIGJI Nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike. Pasi që Udhëzimet administrative nga ky Ligj ende nuk janë bërë, Projekti në fjalë është bartur në vitin 2025. Bazuar në të KOSTT është duke i përcaktuar prioritetet në plotësimin e kushteve që përcaktohen me këtë Ligj duke filluar me Ndërtesën e Selisë qendrore me Projektin, Ndërtimi i infrastrukturës së Sigurisë së Lartë në Selinë Qendrore” dhe duke planifikuar në vitet në vazhdim projekte të tilla në NS Kosova B, si dhe objektet tjera me rëndësi dhe të përcaktuara si pjesë të infrastrukturës kritike.

KOSTT ka vendos në prioritet veprime tjera për realizimin e parimeve themelore mjedisore të KOSTT-it. Lidhur me këtë ka planifikuar të vazhdojë realizimin e kyçjeve në rrjet të qytetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ujërave atmosferik aty ku ekziston mundësia teknike si dhe rrugëve të qasjes në Nënstacione, duke plotësuar obligimet në aspektin mjedisore.

Me qëllim të krijimit të hapësirave të reja për punë KOSTT parasheh renovimin e hapësirave të mbetura në objektin e saj në Kurriz, duke krijuar zyra të reja, hapësira për depo dhe arkiva.

Gjithashtu parashihen edhe punime në rregullimin e jashtëm infrastrukturorë të Nënstacioneve Kosova B, etj.

### 11.7. Marrëdhëniet efektive me palët e interesit

KOSTT beson që përgjegjësia dhe transparenca ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit janë ndër parimet bazë në përmbushjen e mandatit të saj si institucion publik, derisa reputacioni është një nga asetet e rëndësishme strategjike i cili ka ndikim në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e besimit të palëve interesit. Rrjedhimisht, KOSTT nëpërmes Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun në përputhje me Strategjinë e rishikuar të Komunikimit, për vitet në vijim planifikon realizimin e aktiviteteve në shërbim të mirëmbajtjes dhe avancimit të imazhit të kompanisë, avancimin e raporteve me palë të interesit vendore dhe ndërkombëtare, informimit të opinionit dhe palëve të interesit në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e KOSTT, avancimin e komunikimit të brendshëm, realizimin e publikimeve, organizimin e ngjarjeve për të prezantuar dhe promovuar të arriturat e kompanisë si dhe vazhdimin e zhvillimit të projekteve promovuese në vazhdimësi.

Si një nga akterët qenësor në sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend si dhe palë kyçe për bashkëpunim dhe operimi në sinkron me OST-të fqinje dhe Sistemin Evropian të Transmetimit, KOSTT do të jetë proaktive në avancimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunim rajonal me operatorët e sistemeve të transmetimit, dhe institucionet e tjera të energjisë në vend, rajon dhe Evropë.

KOSTT sh. a e konsideron Përgjegjësinë Shoqërore të Korporatave (CSR) si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon duke inkorporuar politikat e biznesit të përgjegjshëm në politikat e brendshme të kompanisë dhe më tutje duke ndërmarrë aktivitete në shërbim të komunitetit. Në këtë drejtim KOSTT planifikon të vazhdoj me përkushtimin konsistent në avancimin e parimeve të CSR, për të kontribuar në arritjen e agjendës globale për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) - Agjenda 2030.

KOSTT në vazhdimësi zbaton politikë të integruar të komunikimit me qëllim të ruajtjes së cilësisë, qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së informatave derisa në përputhje me qasjen transparente si një nga vlerat themelore të kompanisë do të trajtoj me kujdes kërkesat nga palët e interesit, mediat, OJQ-të dhe kërkesat e tjera që ndërlidhen me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

- **Vazhdimi i mirëmbajtjes së imazhit dhe besimit në opinionin publik**

KOSTT synon të forcojë imazhin dhe besimin publik përmes mesazheve të qarta që theksojnë angazhimin për zgjidhje të qëndrueshme energjetike. Promovimi i infrastrukturës aktuale dhe projekteve në zhvillim do të realizohet përmes pamjeve vizuale, video projekteve dhe përmbajtjeve multimediale, duke shfaqur përparimet e kompanisë. Një fokus i veçantë do të jetë krijimi i përmbajtjeve edukative për publikun rreth energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitetit energjetik. Këto përmbajtje do të rrisin ndërgjegjësimin për kontributin e KOSTT-it në një të ardhme më të gjelbër, duke ndërtuar një lidhje më të fortë me komunitetin dhe duke frymëzuar besim në projektet e saj afatgjata. KOSTT do të vazhdojë të fokusohet në ruajtjen e imazhit të saj të besueshëm përmes angazhimit ndaj transparencës dhe përparimeve në sektorin energjetik. Me anë të projekteve të reja dhe përmbajtjeve vizuale të mirëstrukturuara, kompania synon të informojë

publikun për nismat e qëndrueshme dhe të përfshijë komunitetin në arritjen e objektivave për një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme. Edukimi i publikut për energjinë e ripërtëritshme dhe kontributet e KOSTT-it do të jetë një pjesë kyçe e strategjisë për të forcuar më tej besimin dhe përfshirjen e publikut në këto iniciativa.

- **Strategji Inovative e Komunikimit dhe Relacioneve me Publikun**

Në kuadër të strategjisë së re të komunikimit dhe relacioneve me publikun, një ndër prioritetet kryesore të KOSTT-it do të jetë realizimi i aktiviteteve që përputhen me objektivat e Paktit Global të Kombeve të Bashkuara (UN Global Compact). Kjo nismë ka për qëllim zbatimin e dhjetë parimeve të përcaktuara në fushat e të drejtave të njeriut, standardeve të punës, mjedisit dhe luftës kundër korrupsionit. Qëllimi është që pjesëmarrësit dhe palët e interesuara të integrojnë këto parime në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tyre të biznesit. KOSTT do të punojë ngushtë me partnerë dhe palë të tjera të interesuara për të përshpejtuar veprimet që mbështesin gjithashtu Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të OKB-së, duke promovuar praktikat e qëndrueshme që përfshijnë të gjitha nivelet e operacioneve të saj. Kjo strategji pesëvjeçare përfshin edhe shënimin e një momenti të rëndësishëm historik për KOSTT-in, 20-vjetorin e themelimit të saj. Me këtë rast, kompania ka planifikuar një sërë aktivitetesh dhe evenimente publike që do të përfshijnë bashkëpunime me komunitetin lokal, partnerët dhe aktorët kyç në sektorin energjetik, duke theksuar arritjet dhe kontributin e kompanisë në zhvillimin energjetik të vendit. Kjo festë do të shërbejë si një mundësi për të forcuar lidhjet me publikun dhe për të reflektuar mbi sukseset dhe sfidat e kaluara, duke shikuar gjithashtu drejt të ardhmes me plane ambicioze për rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve.

Një tjetër komponent kyç i strategjisë është ridizajnimi dhe modernizimi i webfaqes së KOSTT-it, që synon ta bëjë atë më të aksesueshme dhe më të përshtatshme për nevojat e përdoruesve, duke përfshirë teknologjitë më të fundit informative. Webfaqja e re do të përmbajë funksione të përparuara që lehtësojnë qasjen në informacion, përmirësojnë transparencën dhe rrisin ndërveprimin me palët e interesuara. Ky ridizajnim do të jetë pjesë e përpjekjeve më të gjera për të përshtatur aktivitetet e KOSTT-it me zhvillimet globale në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, duke e bërë kompaninë më të përgatitur për sfidat e ardhshme.

Kjo strategji e komunikimit dhe relacioneve me publikun synon të vendosë KOSTT-in në ballë të inovacionit, transparencës dhe përfshirjes sociale, duke forcuar pozitën e saj si një aktor kryesor në sektorin energjetik të Kosovës.

- **Qëndrueshmëria, mirëqenia dhe angazhimi në komunitet**

Në përpjekjet e saj për të promovuar qëndrueshmërinë dhe angazhimin në komunitet, KOSTT do të zhvillojë fushata edukative për të nxitur njohurinë rreth çështjeve të qëndrueshmërisë dhe do të zbatohet praktikat më të qëndrueshme në të gjitha operacionet e kompanisë. Po ashtu, do të zhvillohen dhe integrohen politikat e qëndrueshmërisë në strukturën korporative, duke përfshirë edhe përpilimin e raporteve të qëndrueshmërisë që reflektojnë performancën dhe progresin e kompanisë në këtë fushë.

Në aspektin e përgjegjësisë sociale, një vëmendje e veçantë do ti kushtohet sponsorimit të aktiviteteve filantropike dhe promovimit të vlerave kulturore të Kosovës. KOSTT do të angazhohet në përmirësimet infrastrukturore në komunitetet që preken nga projektet e saj, veçanërisht përmes projekteve investive që ofrojnë përfitime të qëndrueshme për komunitetet lokale.

Për të siguruar se angazhimi për barazi gjinore mbetet një prioritet, KOSTT do të zhvillojë dhe zbaton politika të qarta që promovojnë përfshirjen dhe avancimin e grave në të gjitha nivelet e organizatës. Kjo përfshin trajnime për ndërgjegjësimin gjinor, nisma për balancimin e jetës profesionale dhe personale, dhe mbështetjen e karrierave të grave në fushat teknike dhe menaxheriale. Si pjesë e kësaj strategjie, KOSTT do të implementojë politikën për barazi gjinore dhe një politikë kundër ngacmimit seksual. Këto politika do të sigurojnë një mjedis pune të sigurt dhe mbështetës për të gjithë punonjësit, duke përfshirë masa të qarta dhe të qëndrueshme për trajtimin e çështjeve të ngacmimit dhe diskriminimit. Angazhimi në këto nisma do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të barabartë dhe inkurajues për të gjithë punonjësit, duke kontribuar në një kulturë korporative më të pasur dhe më të qëndrueshme.

### 11.8. Prokurimi Elektronik

Aplikimi i platformës së prokurimit elektronik nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese në Kosovë, e gjithashtu edhe në KOSTT sh.a., ka filluar nga fillimi i vitit 2017, në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës se Kosovës për funksionalizimin e platformës së prokurimit elektronik. Përmes kësaj platforme, KOSTT tani realizon në formë elektronike blerjen e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve.

Qëllimi i Prokurimit Publik është që të rrit shkallën e përgjegjshmërisë, të siguroj vlerën më të mirë për paranë publike, duke respektuar rregullat që dalin nga Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë. Përdorimi i sistemit elektronik garanton një proces transparent dhe siguron kushtet për një konkurrim të hapur ndërmjet operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Edhe për periudhën e ardhshme pesëvjeçare 2023-2027, aktivitetet e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me parimet bazike, të cilat janë:

- Konkurrenca – në mesin e furnizuesve duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive;
- Efikasiteti dhe Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues;
- Drejtësia/Mos-diskriminimi – të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për furnizuesit ose furnizuesi potencial.
- Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar;
- Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose që paraqet afektim të vendimit;
- Transparenca – të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente;
- Profesionalizëm – të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar; dhe
- Legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.